



USHTRIA



Viti i 77-të i botimit Nr. 28 (827883)

Botim Qendror i Ministrisë së Mbrojtjes

E premte, 19 korrik 2024



**Përballja me zjarret, Peleshi:
Mirënjohje për përkushtimin
e paçmuar të çdo efektiv
të Forcave të Armatosura**

» faqe 4

Kontingjenti V i anijes “Oriku” P-138, pjesë e operacioneve “SeaGuardian” në Detin Egje

Në kuadër të dislokimit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë në operacionin e NATO-s në detin Egje, në Distriktin Detar Jugor, Pashaliman u zhvillua ceremonia për përcjelljen në mision të anijes “Oriku” P-138, e cila është pjesëmarrëse për të tretën herë në aktivitetin e NATO-s në detin Egje.

Në ceremoni morën pjesë zëvendësministri i Mbrojtjes Dorian Tola, komandanti i Forcës Detare, kundëradmiral Adnand Agastra, personel të Forcës Detare/Rojës Bregdetare si dhe familjarë të efektivave që janë pjesë e kontingjentit V.

Komandanti i Forcës Detare, kundëradmiral Agastra theksoi se: “Efektivët e Forcës Detare/Rojës Bregdetare po vazhdojnë të tregojnë profesionalizëm të lartë në kryerjen e detyrave të tyre, duke u bërë shembull për aleatët tanë.

Forca Detare/Roja Bregdetare ndikuar nga gjeopolitika në rajon si dhe të diktuar nga kushtet dhe detyrat e NATO-s po ndryshon dhe transformohet në përmirësimin e rritjes operacionale, në aftësimin e personelit dhe ndërveprueshmërinë me vendet aleate partnere të Aleancës.

Në përfundim të fjalës, komandanti i FD-së iu uroi suksese në shërbimin ndaj atdheut dhe Aleancës.

Efektivi i kontingjentit pjesëmarrës në mision u përshëndet dhe nga zëvendësministri i Mbrojtjes Dorian Tola, i cili u shpreh: “Jemi të bindur se edhe ju do të kryeni detyrën e ngarkuar nga Aleanca me të njëjtin sukses dhe



përkushtim si më parë. Në 4 kontingjentet e para në mision janë arritur të shpëtohen mbi 400 jetë, ndër këto dhe gra e fëmijë, të cilëve iu rrezikohej jeta duke tentuar të kalonin kufirin jashtë kushteve të sigurisë lundrimore”.

Në përfundim të fjalës së tij, zëvendësministri falënderoi fëmijët e efektivëve dhe iu siguroi kujdesin e vazhduar të Ministrisë së Mbrojtjes.



Kursantët e Përgatitjes së Oficerit të Ri (KPO) mbrojnë temat e përfundimit të kursit



Në kuadër të bashkëpunimit ndërmjet Gardës Kombëtare të New Jersey-it dhe Qendrës së Arsimit të Profesionit të Nënoficerëve, në ambientet e QAPN-së, u zhvillua aktiviteti “Senior NCO Development”.





Ministri i Mbrojtjes Peleshi takohet me ndihmëssekretaren për Politikën e Mbrojtjes dhe të Jashtme në DASH, znj. Jessica Lewis

Ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi zhvilloi gjatë Samitit të NATO-s, në Uashington një takim me znj. Jessica Lewis, ndihmëssekretare për Politikën e Mbrojtjes dhe të Jashtme, në Departamentin Amerikan të Shtetit. Z. Peleshi siguroi znj. Lewis për angazhimin e Shqipërisë për të përmbushur të gjitha detyrimet që Ministria e Mbrojtjes dhe Forcat e Armatosura kanë në projektet e përbashkëta, të listuara në dokumentin “Lines of Efforts 2023-2027”, dokument ky i nënshkruar në shtatorin e vitit të kaluar në Tiranë, në përfundim të bisedimeve dypalëshe SHBA-Shqipëri në fushën e Sigurisë dhe Mbrojtjes.

Ministri i Mbrojtjes dhe zyrtarja e DASH diskutuan për situatën në Ukrainë dhe atë në Ballkanin Perëndimor. Z. Peleshi kërkoi vëmendje të shtuar të Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe aleatëve të tjerë kryesisht për Veriun e Kosovës, duke u shprehur shqetësimin për incidentet e herëpashershme të provokuara nga elementë me lidhje të ngushtë me Beogradin.



Në lidhje me situatën në Ukrainë, ministri i Mbrojtjes theksoi se Shqipëria do të mbetet thellësisht e angazhuar në ndihmën e saj ndaj popullit ukrainas. Teksa detajoi ndihmën logjistike që vendi ynë ka dhënë nga janari 2024, ministri Peleshi foli edhe për punën që po bëhet për paketat e reja të ndihmës dhe pjesëmarrjen në misionin trajnues “Interflex” për Forcat e Armatosura të Ukrainës.

Gjatë takimit u diskutua edhe për projektet e Korridorit VIII, Porto Romanos dhe rijetësimin të industrisë ushtarake. Në lidhje me këtë të fundit ministri Peleshi theksoi ofertën për bashkëpunim drejtuar firmave të mëdha amerikane që operojnë në këtë fushë.

Nga ana e saj, znj. Lewis rikonfirmoi mbështetjen e Shteteve të Bashkuara për Shqipërisë, aleatit strategjik të vendit tonë dhe një nga partnerët më të besueshëm në Ballkan.

Certifikohet personeli për operimin dhe mirëmbajtjen e sistemit të radarit TPS 77

Për një periudhë njëmuajore në vend dislokimit të radarit TPS 77, Midë, u krye trajnimi i personelit për operimin dhe mirëmbajtjen e këtij radari.

Trajnimi u zhvillua nga dy instruktorë të kompanisë “Lockheed Martin” dhe në të morën pjesë 8 kursantë, të Qendrës së Kontroll - Raportimit, me formim nga fusha e elektronikës dhe e teknologjisë së informacionit.

Programi i trajnimit, i shtrirë në 5 javë kalendarike pune, përmbante tema teorike mbi njohjen me elementët përbërës të radarit, teorinë e operimit të secilit komponent përbërës dhe të të gjithë sistemit të radarit, llojet e kontrolleve dhe mirëmbajtjes periodike, diagnostikime të defekteve të ndryshme, studimin e skemave inxhinierike të komponentëve përbërës, si dhe ushtrime praktike për kryerjen e inspektimeve, matjen e parametrave të ndryshëm teknikë me instrumente matës, ndërrimin e pjesëve të defektuara, kryerjen e kalibrimeve dhe



akordimeve të ndryshme nëpërmjet programit softuerik, si dhe ushtrime të tjera praktike për njohjen e programit të sistemit të kontrollit të mirëmbajtjes.

Në ceremoninë e organizuar me rastin e përfundimit të këtij trajnimi, si dhe për certifikimin e personelit, mori pjesë komandanti i Faj-së,

gjeneral brigade Ferdinand Dimo.

Në fjalën e tij, gjeneral Dimo, pasi shprehu rëndësinë që kjo postë ka për Forcat e Armatosura në përgjithësi, por edhe për Faj-në në veçanti, në drejtim të mbajtjes në operacionalitet të sistemit të vëzhgimit ajror, falënderoi instruktorët e kompanisë “Lockheed Martin” për bashkëpunimin



dhe kontributin e tyre. Nga ana tjetër, ai falënderoi edhe personelin kursant mbi arritjen e rezultateve të duhura në përfundim të trajnimit, duke theksuar se tashmë FARSH-të dhe FAJ-të kanë edhe një aset tjetër të shtuar oficerësh të trajnuar, për të mirëmbajtur dhe ruajtur gatishmërinë operacionale të sistemit të radarit TPS 77 në Faj.

4 vatra aktive zjarri ishin në të gjithë territorin e vendit. Problematikë mbetej situata e zjarrit në Balgjaj në fshatin Kurdari. Forcat operacionale nën koordinimin e Agjencisë së Mbrojtjes Civile vijnë në mbanin nën kontroll situatën, për të shmangur rrezikun pranë një stani me bagëti e dhjetëra koshere bletësh.

Në fshatin Madhesh, njësia administrative Ulëz në Mat, zjarri i rënë mori përmasa të menjëhershme dhe avancoi në drejtim të fshatit Stojan. Veç forcave operacionale në terren shkuan në ndihmë edhe helikopteri “Cougar”.

Vijoi ndërkaq edhe operacioni për shuarjen e flakëve në vatrën e zjarrit të rënë në Buza Dede mbi fshatin Gurë-Lurë, ku flakët ishin pranë liqeneve të Lurës.

Era e fortë vështirësoi aksionin për shuarjen e zjarrit edhe në vatrën e regjistruar një ditë më parë midis malit të Xhyrës dhe njësisë administrative Qukës në bashkinë e Përrenjasit.

Të gjitha forcat operacionale u shpërndanë me grupe në zona të ndryshme për të krijuar një perimetër për të ruajtur vijën e zjarrit ekzistues dhe për të fikur çdo aktivizim në kufijtë e zjarrit dhe në thellësi të tij.

Sipas të dhënave nga Qendra Kombëtare Operacionale e Emergjencave Civile në AKMC, në Qarkun e Dibrës vijoi puna nga terreni dhe ajri për shuarjen e zjarrit të rënë në fshatin Kurdari, bashkia Klos. Vatra e zjarrit në Balgjaj të fshatit Kurdari u zhvillua në dy vatra, njëra prej të cilave u vu nën kontroll.

Një prej vatrave u zhvillua në drejtim të liqeneve të Balgjajt, Kurdari në sipërfaqe me filiza pishe e ahu, por u mbaj pjesërisht nën kontroll. Për fikjen e zjarrit u angazhuan 23 forca dhe helikopteri i FA-së. Nuk u rrezikuan banesa.

Vijoi puna për shuarjen e zjarrit të rënë në Buza Dede mbi fshatin Gurë-Lurë, bashkia Dibër, me dy vatra zjarri aktive, njëra në kullotë, ndërsa vatra tjetër po zhvillohet në pyll me ah në vendin e quajtur Plehenaj, ku zjarri u zhvillua shumë aktiv i ndihmuar nga temperaturat e larta, era e fortë si dhe mbetjet e thata të grumbulluara ndër vite. Efektivë zjarrfikës, forca nga Administrata e Zonave të Mbrojtura, forca bashkiake e vullnetare po punojnë për vënien nën kontroll të flakëve.

Po ashtu në qarkun e Elbasanit, midis malit të Xhyrës dhe njësisë administrative Qukës, bashkia Përrenjas, ka rënë zjarr në një sipërfaqe me ah, dëllinjë dhe panjë. Punonjësit në terren izoluan vatrën e zjarrit dhe e mbajtën atë nën kontroll, por për shkak të sasisë së madhe të humusit zjarri në brendësi vazhdon dhe ka forcë. 25 efektivë të FA-së u përfshirë në këtë aksion, duke vënë nën kontroll flakët, por vazhdon puna për ta mbajtur atë të izoluar.

Ndërkaq është fikur një vatrë e raportuar në malin e Trushnicës, në Tepelenë, por po mbahet në monitorim nga forcat bashkiake për të mos u riaktivizuar.

Situatë e vështirë zjarresh edhe në fshatin Kakodhiq të bashkisë Delvinë për izolimin e plotë të vatrës, i cili ishte vazhdimi i zjarrit masiv që kish përfshirë fshatin Kardhikaq në bashkinë Finiq. Në vendngjarje operuan forcat zjarrfikëse të bashkisë Delvinë dhe efektivë të Forcave të Armatosura.

Po ashtu Forcat e Armatosura izoluan vatrën e zjarrit pranë liqeneve të Lurës, në fshatin Gurë - Lurë të bashkisë Dibër, vazhdim i zjarrit të rënë në një sipërfaqe me pisha. Në terren efektivët zjarrfikës të bashkisë Dibër, forca nga administrata e Zonave të Mbrojtura, Shërbimi Pyjor e forca bashkiake si dhe 50 efektivë nga Forcat e Armatosura.

Ju lutemi banorëve të bëjnë kujdes! Ligji parashikon dënim të rëndë për të gjithë ata që ndezin zjarre dhe do të zbatohet për çdokënd, pa dallim!

Pas një pune të pandërprerë forcat e Emergjencave Civile, nën koordinimin e Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile kanë bërë të mundur shuarjen e zjarrit në bashkinë Dropull, ku situata po vazhdon të monitorohet për të shmangur çdo mundësi riaktivizimi.

Në fshatin Kakodhiq në bashkinë e Delvinës po vijon aksioni me forcat e bashkisë, efektivët e Forcave të Armatosura, forca shtesë zjarrfikësish nga Berati, por edhe dy avionë PZL nga Greqia, për shuarjen e flakëve.

Po ashtu operacioni vazhdon edhe pranë liqeneve të Lurës në Dibër.

Mirënjohje të gjithë efektivëve të angazhuar si dhe autoriteteve greke që po asistojnë me dy avionët tip PZL në shuarjen e flakëve në fshatin Kakodhiq!

Përsërisim thirrjen për kujdes të shtuar gjatë këtyre ditëve me temperatura të larta, në mënyrë që të shmangen ngjarje që dëmtojnë



Përballja me zjarret, Peleshi: Mirënjohje për përkushtimin e paçmuar të çdo efektiv të Forcave të Armatosura



mjedisin dhe pasurinë tonë të përbashkët!

Sipas të dhënave nga Qendra Kombëtare Operacionale e Emergjencave Civile në Agjencinë Kombëtare të Mbrojtjes Civile



(AKMC), gjatë 24 orëve të fundit janë raportuar 14 vatra zjarri, nga të cilat janë shuar 11 vatra dhe janë aktive 3. Sot puna po vijon në bashkinë Delvinë, ku është aktive vatra e zjarrit sipër Manastirit dhe fshatit Kakodhiq.

Në bashkinë Gjirokastrë, efektivët e Forcave të Armatosura dhe ato të emergjencave vendore kanë nisur punën prej orëve të para të mëngjesit për shuarjen e vatrave të zjarrit mbi Malin e Gjerë, ku flakët kanë një shtrirje 10-12 km dhe janë të shpërndara në 3 vatra.

Po ashtu po punohet për shuarjen e zjarrit të rënë dje, pranë liqeneve të Lurës, në fshatin Gurë - Lurë të bashkisë Dibër, ku

ndërhyrja paraqet vështirësi për shkak edhe të terrenit shkëmbor.

Të gjitha kapacitetet në nivel vendor dhe qendror, efektivët zjarrfikës, efektivët e Forcave të Armatosura, forcat bashkiake, forcat policore, punonjës të administratës së Zonave të Mbrojtura, punonjës të Shërbimit Pyjor, forca vullnetare janë në gatishmëri të plotë për mbajtjen nën kontroll të situatës.

Përballja me zjarret në këto temperatura të larta dhe terrene të vështira është një nga sfidat e mëdha të Forcave të Armatosura në këta muaj të nxehtë.

Ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi ndau sot dëshminë e kolonel Dritan Durmishaj, i cili është vetëm njëri nga ushtarakët e shumë që sakrifikojnë çdo ditë në shërbim të vendit dhe qytetarëve.

“Mirënjohje për përkushtimin e paçmuar të çdo efektiv të angazhuar në këtë detyrë, për ndjenjën e përgjegjësisë dhe humanizmit dedikuar mbrojtjes së jetës së qytetarëve tanë, pronës së tyre dhe natyrës së vendit tonë”, - u shpreh Peleshi.

Kolonel Durmishaj shpjegoi se çdo mision kërkon përgatitje: “Mbase për ata që janë jashtë avionit duket shumë e thjeshtë, por për pilotët dhe teknikët duhet një kohë e caktuar që të përgatiten, të gjendet terreni ku do të fluturojë.



Për mjetin ajror, sa më lart të jetë terreni, aq më e vështirë është për të kryer operacionin për shkak të ngarkesës dhe kushteve meteorologjike”, - u shpreh ai.

Kolonel Durmishaj flet edhe për misionin e fundit: “Morëm një thirrje nga AKMC për një fshat në Klos, ku një masiv pyjor kishte marrë zjarr dhe për shkak të terrenit shumë të vështirë malor dhe të thepisur kërkohej edhe ndërhyrja e mjeteve ajrore. Me të marrë sinjalin, ekuipazhet u përgatitën dhe filluan detyrën, duke ndihmuar forcat zjarrfikëse, të cilat ndodheshin në terren”, - tha ai.



Forca dhe mjete të kompanisë së parë operacionale në Bazë të Mbështetjes së Emergjencave Civile në Komandën Mbështetëse, në krye të detyrës për shuarjen e zjarreve

Temperaturat e larta të cilat kanë përfshirë vendim tonë kanë ndikuar në shfaqjen e disa vatrave të zjarrit në zona të ndryshme.

Krahas ndërhyrjes së strukturave të tjera, një rol shumë të rëndësishëm në stabilizimin e situatës kanë dhënë dhe efektivet e Bazës së Mbështetjes së Emergjencave Civile në Komandën Mbështetëse.

Më datë 09 korrik, Emergjencat Civile janë angazhuar në operacionin për shuarjen e zjarrit në fshatin Kardhikaq, njësi administrative Mesopotam, bashkia Finiq.

Me sakrificë, këmbëngulje, punë të vazhdueshme dhe duke u përballur me kushtet e vështira atmosferike (erërat e forta të cilat përhapnin zjarrin me shpejtësi) efektivet me mjete zjarrfikëse dhe pajisje të tjera bënë të mundur shuarjen e 74 vatrave të zjarrit, duke penguar depërtimin e tij në brendësi të fshatit dhe banesave.

Njëkohësisht një ndërhyrje e rëndësishme e efektiveve të Komandës Mbështetëse ishte dhe ajo në zonën e Dropullit, në fshatrat Terihat dhe Dhuvjan.

Më datë 11 korrik efektivet e kompanisë së kërkim shpëtimit u përfshinë në një tjetër operacion për shuarjen e zjarrit në bashkinë Delvinë. Forcat dhe mjetet zjarrfikëse u pozicionuan në segmentin Manastiri i Kamenës dhe rrugës së fshatit Kakodhiq, duke i bërë ballë situatës kritike të krijuar nga zjarri i përhapur në një gjatësi rreth 1 km dhe në veçanti duke mos lejuar afrimin pranë fshatit, banesave dhe vend burimit të gazit në Delvinë. Komanda Mbështetëse me efektive të trajnuar dhe mjetet e posaçme përmbush misionin e saj në ndihmë të komunitetit përmes shuarjes së zjarreve, duke i ardhur në ndihmë popullsisë civile dhe mjedisit përreth.



Personeli ushtarak dhe civil i DMR, Mengel, pjesë e fushatës për dhurimin vullnetar të gjakut

Komanda mbështetëse së bashku me nënrepartet vartëse ka nisur angazhimin e saj për të kontribuar në kuadër të fushatës së dhurimit vullnetar të gjakut.

Detashmenti i Mbrojtjes Rajonale, Mengel, bëhet struktura e parë, e cila nis fushatën e dhurimit të gjakut në bashkëpunim me stafin mjekësor të Qendrës Kombëtare të Transfuzionit të Gjakut.

Në ambientet e qendrës shëndetësore të Batalionit të Mbështetjes Rajonale, Mengel, personeli ushtarak dhe civil i kësaj strukture iu bashkuan nismës sa humane aq dhe jetike për të dhuruar vullnetarisht gjak.

Fushata e dhurimit vullnetar të gjakut do të vazhdojë në struktura të tjera të Komandës Mbështetëse.

Kolegji i Mbrojtjes dhe Sigurisë zhvilloi analizën e punës 6-mujore

Kolegji i Mbrojtjes dhe Sigurisë zhvilloi analizën e punës për 6-mujorin e parë të vitit 2024. Në këtë aktivitet morën pjesë komandanti i Kolegjit të Mbrojtjes dhe Sigurisë gjeneral brigade Ylli Pulaj, zëvendëskomandanti i Kolegjit, kolonel Arben Toska si dhe komandantja e kurseve, shefat e departamenteve, degëve dhe sektorëve.

Shefat e departamenteve dhe drejtuesit e strukturave prezantuan punën e bërë për arritjen e objektivave të realizuar në mbështetje të misionit të Kolegjit dhe urdhrave të ardhur, gjatë 6-mujorit të parë të vitit 2024 si dhe detyrat kryesore si: plotësimi i strukturës organike me personel, monitorimi dhe zhvillimi i programit mësimor me pjesëmarrësit në kurset institucionale: KKSHP, KLO dhe KLMS-14, duke u ndalur tek zhvillimi i dy moduleve në gjuhën angleze me kursantët e Kursit të Lartë të Oficerit, prakti-

kat për fillimin, zhvillimin dhe mbylljen e Kursit të Lartë për Sigurinë dhe Mbrojtjes (KLMS-14), përmirësimin e infrastrukturës mësimore si dhe puna për përgatitjen e programeve të mbrojtjes 2025-2030 dhe planifikimin afatmesëm.

Më pas, të pranishmit diskutuan dhe mbi disa risi dhe përmirësime në kurrikulën, programet mësimore si dhe infrastrukturën dixhitale dhe hidrosanitare të institucionit.

Në përfundim komandanti i Kolegjit, gjeneral brigade Ylli Pulaj falënderoi të pranishmit për realizimin në kohë të çdo detyre të dhënë, duke mbyllur me sukses vitin akademik 2023-2024 dhe u shpreh për angazhimet në vijim mbi rishikimin e programeve mësimore dhe infrastrukturë me qëllim përgatitjen për hapjen e vitit të ri akademik në vjeshtë të këtij viti me objektiva qartësisht të fokusuara në misionin e Kolegjit të Mbrojtjes dhe Sigurisë.





ANJEZA MUSOLLARI,
Shefe e Sektorit të Botimeve

Le të themi se kjo është ‘Epoka e Dyftytyrësisë’, dhe kjo është trend i mbijetesës së shëmtuar të dalë jashtë mode. Të dish se kujt t’i besosh është pjesë e rëndësishme e jetës së përditshme.

Instinktivisht ne mund t’i besojmë një personi, por nuk e kuptojmë plotësisht pse i besojmë atij dhe jo një tjetri. Në jetë, herët a vonë, të gjithë kemi pasur të bëjmë me njerëz të rremë, një mik apo mikeshë me sjellje të paqartë, dikush, mendimet dhe ndjenjat e të cilit nuk kanë qenë asnjëherë të qarta, ose më keq akoma, dikush që në fund del ekzaktësisht e kundërta e asaj që tregonte në sipërfaqe.

Hulumtues të ndryshëm në dekada, janë përpjekur t’i japin përgjigje këtij fenomeni, duke u përpjekur të bashkojnë dhe kryqëzojnë studime të ndryshme dhe më në fund e kanë një “identikit” të njeriut për të cilin, siç i thonë shqiptarçe, ti “vë dorën në zjarr”.

Nuk ka njerëz të këqij, por vetëm të pakënaqur nga jeta, të cilët detyrohen të sillen jo mirë dhe të kenë dy fytyra, ose dhe më shumë, sipas rastit.

Herët ose vonë çdokujt do t’i rastisë të njohë një të tillë, nëse ende nuk e ke njohur kthe pak kokën në të djathtën tënde.

Dyftytyrësh apo hipokrit?!

Të dyja personalitete toksike që i hasim në çdo lloj shoqërie, është hipokrit apo dyftytyrësh janë e njëjta gjë.

Për shkak të natyrës së tyre, na duhet shpesh shumë kohë për të kuptuar qëllimet e tyre të vërteta, sepse ata arrijnë t’i fshehin hapat e tyre pas një miqësie të shtirur me ne, apo një dashurie akoma më të shtirur. Por nëse kërkon t’i njohësh dhe t’i demaskosh në mënyrë efikase persona të tillë, të ftojme të lexosh më poshtë disa nga karakteristikat e tyre më të shpeshta.

Ka dy mënyra për t’i mbajtur larg këta njerëz

Ose të biesh në nivelin e tyre dhe të ndërtohet një marrëdhënie mbi hipokrizinë që herët ose vonë do shkatërrohet vetë. Ose përballu, demaskoje dhe gjithsesi do ta largosh.

Kur bie maska dhe zbulojmë fytyrën e vërtetë të atij që kujtonim një mik, që hyn me të drejtë në kategorinë e njerëzve fals, zhgënjimi dhe ndjenja e tradhtisë mund të jenë të mëdha, sidomos nëse kemi investuar shumë në atë marrëdhënie dhe besojmë në miqësinë që na lidh me atë person.

Si ta dallojmë falsitetin e një personi para se të jetë tepër vonë?

“Ana bën sikur është naive. Bledi është një parazit. Artani tradhton Mirën me shoqen e së motrës, por asaj mirë t’i bëhet se u martua me të për interes...”, e kështu me radhë (aspak çudi, në institucionet tona është kthyer në një gangrenë). Nëse ky person, që mendoni se e keni mik të ngushtë flet në këtë mënyrë për miqtë e tjerë apo për të njohur, duhet të pyesni veten se si mund të flasë për ju, apo jo?!

Nëse gjuha e tij është e ashpër aq sa mund të lëndojë, të jeni të sigurt që herët a vonë do t’ju lëndojë edhe ju, në momentin e parë që do të largoheni prej tij. Kush ka gjithmonë një mendim ‘të mirë’ për të gjithë, një ditë do ta ketë edhe për ju.

“Mos u beso atyre që flasin keq për të tjerët. Nëse ai nuk është besnik ndaj miqve të tij, nuk do të jetë besnik as ndaj jush”



Gënjeshtër, zili, krahasim, ndjenjë gare Jo rrallë njerëzit e gënjeshtër janë të tillë, sepse ndihen të pasigurt dhe kanë një kompleks inferioriteti dhe pamjaftueshmërie në krahasim me të gjithë dhe gjithçka.

Kjo gjë i shtyn të gënjejnë shpesh, të tregojnë mbi gjëra që vështirë se ndodhin ku janë protagonistë të pabesueshëm, që vihen për gjithçka në garë me të tjerët dhe shfaqin ndjenja të çuditshme për atë që është më i pasur, më

inteligjent, ka më shumë shokë, ka më shumë miq. Por nëse i bëni të besojnë se janë më të mirë, do ta bëni atë të padëmshëm. Ndhimojnë vetëm ata, nga të cilët mund të përfitojnë diçka.

Të bashkëpunojnë persona të tillë me të tjerët është mjaft e rrallë. Por kjo gjë ndodh, sidomos me ata persona, me të cilët kanë njëfarë përfitimi mbrapsht. Do ta vini re këtë cilësi të tyre, nëse do të jenë duke kaluar nëpër një problem të caktuar dhe do t’ju përdorin juve si

një trampolinë për të arritur objektivat e tyre. Mos harro se këtë qëllim të tyre, ata përpiqen ta fshehin në maksimum.

Nuk u intereson të humbasin një shoqëri për të arritur një objektiv të tyre: Të sakrifikojnë dikë për të arritur ato që dëshirojnë, është pjesë e rutinës së një personi dyftytyrësh. Ata i trajtojnë njerëzit si paratë, të cilat i përdorin për të arritur diçka.

Dyftytyrësit nuk shqetësohen asnjëherë për vlera, si ndershmëria, sakrificat, apo respekti për të tjerët, sepse mirëqenia e tyre është gjithmonë më e rëndësishme. Kjo është arsyeja se pse egoizmi mbahet si një nga karakteristikat e tyre dalluese. Mos u habit, nëse do të të zëvendësojë edhe ty me dikë tjetër që do ta manipulojë për qëllimet e veta.

Dyftytyrësia apo hipokrizia në përditshmëri është po aq e natyrshme për njerëzit, sa dhe frymëmarrja

Prindërit këshillojnë e urdhërojnë fëmijët të sillen, ashtu siç ata vetë nuk janë sjellë ndonjëherë, mësuesit mundohen të servirin modele që s’i kanë ndjekur dot etj., apo siç do e përkufizonte hipokrizinë një proverb aziatik: “Teksa goja i lutet Budës, shpirti i falet djallit”.

Kështu që gjithmonë do të rrethohemi nga dyftytyrësit, të cilët nuk do të reshtin së ‘bashkëjetuari’ me të tjerët, por edhe me veten. Kjo ndotje shpirtërore e kakofoni sociale që buron nga zemra, ndoshta duhet të shërohet që secili të mund të pranojë veten për atë që është.

Hipokriti dëshiron medoemos të merret në konsideratë. Ai nuk kujdeset për vlerat e vërteta nëse ato nuk e çojnë drejt suksesit. Hipokriti nuk shqetësohet nëse ato që ai ndjek e përqafton janë vlera të rreme, mjafton që atij t’i japin nderim dhe kënaqësi personale me të cilat të mburret, kjo lloj ndjenje nuk lindi midis qenieve njerëzore, por u shfaq përmes një krijesë shpirtërore të padukshme. Në agim të historisë njerëzore, Satanai përdori një gjarpër si maskim dhe duke pretenduar se kishte qëllime të mira, mashtroi gruan e parë, Evën. Që atëherë, shumë qenie njerëzore kanë pretenduar se ishin ato që nuk qenë në të vërtetë, për të mashtruar të tjerët dhe për të realizuar synimet e tyre egoiste.

Sa herë e humbasim besimin dhe entuziazmin, kur kuptojmë dhe përballemi haptazi me faktin se bota është e veshur me nepotizëm, urrejtje, falsitet, antagonizëm e xhelozit!

Aktualisht, hipokrizia është shndërruar në prioritet të veprimtarisë njerëzore dhe përqaftja e saj ndaj brezave të rinj, sa vjen e bëhet më e theksuar.

Me zhgënjim dhe dyshim mund të ngremë pyetjen, nëse hipokrizia, dyftytyrësia do të zhduket ndonjëherë apo do të jetë bashkudhëtare e njeriut, për aq kohë sa Toka do të rrotullohet rreth Diellit.

Por kjo kategori njerëzish në masë të madhe fatkeqësisht nuk duhet të na marrin vëmendjen ata janë veç “Kohë e Humbur”.





DR. ASLLAN ZEMANI

Shërbimi i Shëndetësisë, pararoja e shërbimeve elitare të ushtrisë shqiptare

Në kohën kur Shqipëria ishte pjesë përbërëse, e pushtuara, e Perandorisë Osmane, kohë kur shqiptarët nuk kishin shtetin e për pasojë as Forcat e tyre të Armatosura, nuk mund të bëhej fjalë as për shërbim shëndetësor e spitalor ushtarak të mëvetësuar. Megjithatë në hapësirën mbarë shqiptare ishin bërë të njohur emrat e disa mjekëve ushtarakë, që shërbenin në forcat e armatosura osmane, për arsyt e mësipërme. Midis tyre ishte i përmendur doktor Ibrahim Temo nga Struga etj., që nuk mundën të shërbenin në ushtrinë shqiptare, e cila u formua vetëm pas shpalljes së Pavarësisë së Shqipërisë, në nëntor 1912.

Shërbimi Shëndetësor është një dukuri e kahershme në skemën organizative të Ushtrisë Shqiptare pas vitit 1912. Lidhur me këtë shërbim mjaft të domosdoshëm e jetik për këtë ushtri, në një nga dokumentet më të rëndësishëm, të hartuar e miratuar qysh në prill 1913, me titull “Rregullore e Përkohëshme e Ministrisë së Luftës”, Vlorë, më 22 prill 1913, ku jepej përbërja e kësaj Ministrie dhe e Shtabit Madhor (Shtabi Madhuer) të saj, midis të tjerëve përfshihej edhe “Shërbimi Shëndetësor”. Por natyrisht, kjo strukturë, ashtu si dhe disa të tjera, nuk pati kohë të përvijohet e të vihej në jetë tërësisht e plotësisht nga ana e Ministrisë së Luftës e Qeverisë së Përkohshme të Vlorës, për vetë mënyrën dhe shpejtësinë me të cilat u zhvilluan ngjarjet.

Në vitet njëzet-tridhjetë të shekullit XX, me organizimet dhe zhvillimet që pati Ushtria dhe, në tërësi Fuqitë (Forcat) e Armatosura Shqiptare, edhe ky shërbim erdhi duke u fuqizuar dhe përmirësuar cilësisht. Pikërisht në përbërje të këtij shërbimi tashmë shfaqet edhe një “institucion” me vlera të veçanta, siç është spitali ushtarak.

Njoftimet e para për ngritjen dhe ekzistencën e një spitali ushtarak i përkasin pikërisht këtyre viteve. Kështu e dhëna e parë, e deritashme, e dokumentuar, që bën fjalë dhe dëshmon për ekzistencën e një spitali ushtarak, na vjen nga gjysma e dytë e vitit 1924, është 17 qershori, kur në skemën organizative të Ushtrisë Shqiptare të Qeverisë së F. S. Nolit, për herë të parë përmendet krijimi i një “...Spitali Ushtarak me qendër në Tiranë”. Kurse në vitin 1926, në organikën e përgjithshme të oficerëve të Ushtrisë, me 151 oficerë e aspirantë dhe 23 intendentë, bënin pjesë edhe 5 mjekë ushtarakë.

Por bazat e mirëfillta të mjekësisë ushtarake dhe të shërbimit spitalor ushtarak shqiptar, u hodhën më pas, në periudhën e viteve 1928-1938, kur u ndërmorën disa reformime për riorganizimin dhe përmirësimin e Forcave të Armatosura të Shqipërisë. Plot katër vite më pas, më 24 qershor 1928 miratohet dhe hyn në fuqi “Ligji i parë organik i Ushtrisë dhe i Gjindarmërisë”, sipas të cilit, duhej të ngriheshin “...nga një spital ushtarak në Tiranë dhe në garnizone të mëdha”. Garnizonet e mëdha nënkuptonin qendrat e grupeve ushtarake, që përfaqësonin njësitë më të mëdha për Ushtrinë Shqiptare të asaj kohe, të barabarta me një regjiment. Me anën e këtij ligji organik përcaktohej edhe varësia e spitalit nga Komanda e Fuqive Armate, siç quhej në atë kohë. Pikërisht në qendrën e njërit prej këtyre grupeve, në Spitalin e Elbasanit shërbente mjeku ushtarak i njohur në atë kohë, major Petraq Popa, që kishte hyrë në Ushtrinë Shqiptare qysh më 30 prill 1921. Ky mjek i përkushtuar punoi e shërbeu në këtë spital, me një personel të kufizuar, që nga data 5 shkurt 1930.

Në të vërtetë “datëlindja” e Spitalit të Përgjithshëm Ushtarak Shqiptar daton më 26 shtator 1929, kur në kryeqytetin shqiptar, Tiranë, ai u ngrit dhe nisi veprimtarinë në një godinë të re dykatëshe, pranë rrugës së Dibrës, tek blloku i sotëm i Spitalit Civil “Nënë Tereza”. Këtë fakt e ndesh në shumë dokumente dhe botime të kohës, madje edhe në fotografi. Ky spital ishte pronë shtetërore dhe për ndërtimin e tij qenë harxhuar 548.894.88 franga ari. Një gjë e tillë vërtetohet edhe përmes faqeve të “Ligjit për organizimin e Fuqive Armate”, të vitit 1929, sipas të cilit, tek kreu mbi “Fuqitë Tokësore”, pika “Instituta, Stabilimenta e Reparte të ndryshme (Artikulli 23), bënin pjesë 4 spitale ushtarakë, një prej të cilëve i “Përgjithshëm”, me qendër në Tiranë.

Ende pa kaluar dy vjet, në qershor 1931, pason një ligj për rregullimin e Ushtrisë Kombëtare, i cili konfirmonte gjithashtu, qenien e një Spitali të Përgjithshëm Ushtarak, në Tiranë. Dy ligje të tillë dolën njeri pas tjetrit edhe më 1934 e 1937 dhe në të dy, në përbërje të Forcave Tokësore të Ushtrisë Shqiptare afirmohej prania e një Spitali të Përgjithshëm Ushtarak në Tiranë. Ky spital bënte madje “shërbimin shëndetësor” nën drejtimin e një mjeku që ishte më i vjetri i garnizonit të kryeqytetit. Spitali varej drejtpërdrejt nga Komanda e Fuqive Armate.

Ekzistenca dhe funksionimi i këtij spitali në shërbim të Ushtrisë Shqiptare është i lidhur pazgjidhshmërisht edhe me veprimtarinë e disa mjekëve ushtarakë, të njohur tashmë për

Godina e parë e Spitalit të Përgjithshëm Ushtarak, e ndërtuar më 26.09.1929, ka kushtuar 548.894.88 franga ari



botën mjekësore dhe krejt popullin shqiptar, që punuan me përkushtim në të. Një prej tyre, si përfaqësues ndër më të njohurit ka qenë edhe doktor Sinan Imami, i cili figuron në organikën e këtij spitali me gradën ‘toger’, qysh më 1933. Krahas tij shërbyen edhe të tjerë si kapiten i klasit të dytë, Dr. Selaudin Mborja (që prej vitit 1930); kapiten i klasit të dytë, Dr. Pavli Filloko, (që prej vitit 1933); kapiten i klasit të dytë, Dr. Shan Nush Gjoka (që prej vitit 1932); toger Avdul Nazmi Skënduli, (që prej vitit 1933); toger Spiro Prokop Prosi, (që prej 1933); toger Luigj Benusi, (që prej 1932); toger Kiço Karajani, (që nga 1934); nëntoger, toger Tare Quku, (që nga 1938); Dr. Shyqyri Basha, (që prej vitit 1938); nëntoger, Dr. Petraq Progri, (që prej vitit 1938); nëntoger, Dr. Bahri Kopliku (që prej vitit 1938) e të tjerë. Drejtor i parë i Spitalit të Përgjithshëm Ushtarak ka qenë nënkolonel Dr. Ismet Gega, patolog, që u pasua nga Dr. Selaudin Mborja. Fakti që në këtë spital shërbyen disa mjekë të shquar dhe shumë mjekë të tjerë e personel ndihmës, si dhe tema që lidhen me kapacitetin kurues, llojet e shërbimeve, me kualifikimet e personelit, me rregullat e trajtimit e të mjekimit, e të tjera, përbën pa diskutim një objekt me interes për studim të plotë nga historianë ushtarakë dhe pse jo, edhe nga specialistë të mjekësisë ushtarake shqiptare.

Kaq e vërtetë është ekzistenca e këtij spitali të përgjithshëm sa vet drejtori i tij në vitin 1945, tashmë koloneli Sinan Imami, kishte shërbyer si mjek pikërisht në Spitalin e Përgjithshëm Ushtarak të Tiranës, që nga 1 korriku 1933. Këtë gjë e vërteton më së miri “Lista e përshkallëzimit të oficerëve të përhershëm”, që botohej nga Komanda e Mbrojtjes Kombëtare Shqiptare pothuajse çdo vit deri më 1939.

Pas agresionit fashist kundër Shqipërisë dhe pas pushtimit të saj, më 7 prill 1939, fati i Spitalit të Përgjithshëm Ushtarak Shqiptar ndoqi atë të vet Ushtrisë Shqiptare. Ai u bashkua me strukturat e gjithë Forcave të Armatosura të të dy palëve.

Gjatë viteve të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare pranë

Ushtrisë Nacionalçlirimtare Shqiptare u ngritën e funksionuan disa “spitale partizane”, që kishin një natyrë organizimi dhe veprimi të veçantë, që është e shpjegueshme për kushtet e luftës partizane dhe të Ushtrisë Nacionalçlirimtare Vullnetare Shqiptare. Kurse pas çlirimit të vendit nga pushtuesit e huaj fashistë e nazistë, më 2 shkurt 1945, u ngrit në Tiranë, Spitali i Përgjithshëm (sot Qendror) i Ushtrisë me drejtues (drejtor) të parë ishte pikërisht një nga mjekët e ish-Spitalit të Përgjithshëm Ushtarak të viteve njëzet-tridhjetë të shek. XX. Ky ishte mjeku ushtarak, koloneli Sinan Imami, që tani vinte nga radhët e mjekëve të Ushtrisë NÇ Shqiptare dhe qëndroi si drejtues i këtij institucioni deri në shtator 1973. Më pas, mjekë të shquar kanë qenë drejtues si Dr. Veli Toto, (1973-1989); Dr. Perlat Hodo, (1989-1991); nënkolonel Dr. Ilir Kajo; nënkolonel Dr. Mihal Kërçi; koloneli Dr. Esat Duraku; koloneli Dr. Engjëll Mastori; nënkolonel Dr. Hajri Gërbi; koloneli Dr. Luan Nikollari.

Pas vitit 1945 e deri në ditët tona shërbimi spitalor ushtarak shqiptar, natyrisht ka njohur përmasa dhe nivele të reja zhvillimi, që përpjekshin ta mbanin edhe këtë shërbim tepër të rëndësishëm për mbarëvajtjen e Forcave të Armatosura Shqiptare, në një hap me to. Kështu që mund të thuhet se vënia në punë e Spitalit Ushtarak, në atë ditë shkurti 1945, në të vërtetë, mund të quhet ringritje, në kushte të reja, e ish-Spitalit të Përgjithshëm Ushtarak të viteve ’20-’30 të shekullit të shkuar. Ky argument është më pranë të vërtetës historike ushtarake shqiptare.

Të përpjeksh të shkruash dhe të përkujtos me sa më tepër realizëm këto ngjarje, figura apo institucione për të ndriçuar dhe bërë të njohura ato, është veçse një mënyrë veprimi dhe gjest respekti për veprën e paraardhësve. Njëherësh ai përbën edhe një mesazh vlerësimi dhe njohjeje për ta dhe vet historinë ushtarake shqiptare, larg skemave shabllone dhe tabu, që i bëjnë të paragjyqeshme ato. Madje, meritë do të ishte zbardhja dhe rindërtimi i plotë në pikëpamje historike i strukturave të tyre dhe përshkrimi e evidentimi i vlerave të personaliteteve të tyre drejtuese.



Përirimi i Spitalit Ushtarak të Elbasanit, më 05.02.1930, (i katërti majtas, major Dr. Petraq Popa)



GJENERAL (R) PIRO AHMETAJ
EKSPERT PËR SK, RAJONIN DHE NATO-N,
ZVPRESIDENT I KËSHILLIT ATLANTIKUT

Sytë/vëmendja e kancelarive, institucioneve, instituteve, medias, faktorëve dhe ekspertëve të sigurisë strategjike u drejtuan në Uashington, USA, ku prej dy ditësh u zhvillua Samiti i 37-të i Aleancës së Atlantikut të Veriut (NATO).

I ftuar në “forumin e Senior Ekspertëve të Kolegjit të Lartë të NATO-s”, dëshiroj të ndaj një përmbledhje strategjike mbi mjedisin e sigurisë si dhe “8 Pritshmëritë Historike” të 32 vendeve anëtare (përfshi RSH) prej këtij Samiti Historik: “për mbrojtjen kolektive, ardhmërinë e Aleancës Euroatlantike, gjuhëzimin e Rusinë-Putiniste në Ukrainë, marrëdhëniet me BE-në, stabilitetin e Ballkanit Perëndimor, etj.”:

Mbi Samitet e NATO-s (?) si dhe Pse (?), pikërisht në Uashington, Aleanca Euroatlantike është e destinuar të nënshkruajë historinë e përtej 100-vjetorit të themelimit (1949 -2049)?

Së pari, Samitet e NATO-s nuk janë “rutinë e përvitshme”, por ngjarje në udhëkryqet kritike të përballjes me rreziqet e sigurisë kolektive, që kanë si qëllim: “për të përditësuar dhe modernizuar konceptin, fuqinë ushtarake, rregullat e angazhimit dhe procesin e vendimmarrjes së Aleancës”.

Në historinë 75-vjeçare të NATO-s (1949-2024), nga gjithsej 37 Samite, vetëm 10 janë zhvilluar përgjatë luftës së ftohtë (në 40 vjet) ndërsa 27 prej tyre mbas 1990 deri 2024!

Ndoshta jo rastësisht, po në Samitin e Uashingtonit (1999), për herë të parë NATO u zgjerua me 3 vende të kampit lindor (Poloninë, Hungarinë dhe Çekinë), ndërsa edhe mbas këtij Samiti, pra në 25 vitet e fundit numri vendeve anëtare është dyfishuar (nga 16 në 32 përfshi së fundmi me Finlandën dhe Suedinë).

Numri 3 herë më shumë i Samiteve mbas '90 si dhe dyfishimi i hartës së zgjerimit, flasin më fort se të gjitha fjalimet në Uashington, Bruksel, etj., për dinamikën e paparashikuar të kërcënimeve në 25 vitet e fundit dhe që e legjitimoi NATO-n për 75 vitet që lamë si: “Aleanca më e suksesshme e historisë së njerëzimit”!

Së dyti, në rrafshin gjeopolitik, ky Samit pritet të jetë historik, pasi do të adresojë një nga udhëkryqet më kritike mbas përfundimit të Luftës II Botërore si dhe themelimit të Aleancës (1949), pasi: “mbahet pothuaj 29 muaj mbas agresionit neo-Nazist të Rusisë kundër sovranitetit të Ukrainës stoike si dhe për të sprovuar rendin e sigurisë Globale dhe status quo-në gjeopolitike të vendosur mbas luftës së ftohtë”.

Në këtë mjedis të sigurisë, prioriteti nr.1 i axhendës së Uashingtonit, është modernizimi i fuqisë së pakonkurrueshme ushtarake, përfshi ekspozimin e armëve bërthamore/deterrence: “për frenimin, shkurajimin dhe shpagimin ose hakmarrjen ndaj armiqve që guxojnë të provokojnë apo sulmojnë Aleancën”.

Prandaj, mbas këtij Samiti, Forcat e Gatishmërisë së Lartë të NATO-s planëzohen të arrijnë në mbi ½ milioni (si asnjëherë në 75-vjet), si dhe do të dyfishohen kapacitetet e luftimit të Forcave Ajrore dhe Detare, për të garantuar mbrojtjen kolektive (artikulli-5) nga vendet armiqësore, shtetet apo organizatat terroriste, etj.!

Ndërsa për kërcënimet fatale të Putinit, se: “Rusia do të shkelë traktatin e Armëve Bërthamore nënshkruar nga Presidentët Gorbaçov dhe Regan në 1987 dhe se do t'i bëjnë gjëmën qytetërimin”, përgjigja nga Samiti i Uashingtonit pritet të jetë e ftohtë: “nëse vetëm do të guxonte”, Rusia jo vetëm do të damkosej përjetësisht si “shtet terrorist”, por dhe do ndëshkohet në mënyrë shembullore nga fuqia e USA/NATO. Ndërsa Putini dhe zullumqarët rreth Tij, ashtu si nazistët, Millosheviçët, etj., do dënohen: “për krime kundër njerëzimit”!

Së treti, ky Samit është i “destinuar” të bëjë histori, pasi mbahet mbas gati 880 ditë/net luftimesh të përgjakshme në fushëbetejën “jo vetëm për Ukrainën”, por edhe ndaj kredibilitetit, fuqisë ushtarake dhe interesave gjeopolitike të Aleancës Euroatlantike (SHBA/ NATO/UK/BE).

Prandaj ky Samit, pritet dhe do të skalitet si ndër ngjarjet më madhore që ka zhvilluar Aleanca prej 75 vitesh, pra që prej themelimit të saj (1949), pasi krerët e 32 shteteve anëtare, mblidhen në Uashington për të demonstruar vullnetin politik, kohezionin e palëkundur si dhe vendosmërinë për ta mbështetur Ukrainën deri në fitoren e luftës kundër të keqes së përbashkët (Rusisë-Putiniste).

Kështu, në Uashington, NATO do të demonstrtojë mbështetje pa kompromis ndaj fitores jo vetëm të Ukrainës: “mbi 300 miliardë euro armatime të gjeneratës së fundit (140 miliardë euro nga USA dhe 160 miliardë euro nga BE (p.sh anëtarë më i ri, Suedia 6.6 miliardë euro), nga përdorimi i aseteve të sanksioneve

NATO, Vendime Historike në Samitin e Uashingtonit!



ndaj Rusisë, etj.”.

Pra në Uashington u konfirmua se për Aleancën Euro-atlantike: “nuk ka opsion tjetër përveçse fitores me çdo çmim të luftës ndaj Rusisë”. Për më tepër, që mbas gjuhëzimit në Ukrainë, Moska do të gjendet më e izoluar si dhe do të humbasë peshën gjeopolitike në botë, përfshi Detin e Zi, Ballkan, Mesdhe, etj.

Së katërti, ky Samit zhvillohet në kohën e duhur, por dhe me pritshmëri kritike: “për të modernizuar strukturat, armatimet, pajisjet dhe infrastrukturën ushtarake bazuar në parimin e ndarjes së barrës, pra rritjen në minimumi 2% të buxhetit të mbrojtjes”, në mënyrë që Aleanca të mbetet e pathyeshme: “për t'u përballur me çdo kërcënim, në çdo kohë, nga çdo drejtim dhe ndaj cilido armik potencial”.

Për më të qartë, po citoj Sekretarin e NATO-s, Stoltenberg, i cili një muaj para Samitit, pikërisht në Uashington e cilësoi: “2 % të GDP-së vetëm si minimum”, ndërsa shtoi që 25 vitet të fundit, 2% ka qenë vetëm një objektiv i pa përmbushur nga shumica dërmuese e vendeve anëtare. Si e tillë, në këtë Samit u përshëndet fakti që nga vetëm 5 vende para luftës në Ukrainë (2022), buxheti i mbrojtjes në 2024 arriti në 2 % për 23 vendet e NATO-s, pra rritjen më të madhe të 3 dekadave të fundit pa përfshirë SHBA-të me buxhetin rekord 1 trilion dollar si dhe vendet Europiane të NATO-s me mbi 500 miliardë euro (½ Trilion).

Së pesti, Samiti i Uashingtonit promovoi projekte me peshë të shtuar për integrimin e teknologjive, infrastrukturave, sistemeve dhe aftësive të avancuara kibernetike, armatime luftarake të telekomanduar në distancë (dronë); të inteligjencës artificiale, kompanive private si dhe kohezionin e shoqërisë në hapësirën euroatlantike me arkitekturën dhe misionin e mbrojtjes kolektive të NATO-s.

Për sa posaçërisht Ukrainën, shtoj se në më pak se një muaj para këtij Samiti, po gjatë vizitës në Uashington, Sekretari në detyrë (më 1 tetor zëvendësohet nga Kryeministri holandez, Mark Rutte) Stoltenberg, konfirmoi se: “mbas fitores së luftës, Ukraina do të jetë vendi i 33 i Aleancës”, ndërsa në këtë Samit do të formalizohet “Komiteti NATO – Ukrainë”, pra një hap më afër anëtarësimit. 29 muaj luftime në Ukrainë vërtetuan se Kremli i ka humbur me turp jo vetëm luftën për të pushtuar Ukrainën (përtej propagandës helmuese ruse, në 2 vjet e 5 muaj, vetëm 19 % e territorit të Ukrainës ka arritur të pushtojë) por edhe shpresat për të minuar kohezionin mes NATO-s dhe BE-së. Kështu 32 vendet e NATO-s (27 edhe anëtare të BE-së) në Uashington do të mirënjohin “rolin jetik të SHBA-së”, pasi me rreth 1 trilion dollarë (buxheti-2024) ose 2 herë më shumë se 31 vendet e tjera NATO-s, mban barrën kryesore të shpenzimeve të mbrojtjes si dhe fuqisë ushtarake.

Thënë këtë, në Samit u konfirmua domosdoshmëria e forcimit të marrëdhënieve transatlantike, pra e partneritetit strategjik SHBA/ NATO – BE. Krerët e 27 vendeve të Parlamentit Europian, më 29

qershor 2024 miratuan një zëri një Plan Veprimi (2024-2029) dhe një paketë ambicioze mbështetëse me 500 miliardë euro (20-fishin e shumës aktuale), me qëllim: “kapërcimin e dobësive aktuale si dhe ngritjen e një ushtrie të ndërveprueshme për kërcënimet, kryesisht nga Rusia”.

Gjithsesi, kjo përpjekje dhe ky Projekt i BE-së, që sigurisht nuk është i Ri (Marrëveshjes Berlin-Plus, themeluar në 2002), në Uashington pritet të konfirmohet se kursesi nuk ka si qëllim për të konkurruar me SHBA/NATO, as dublikuar shpenzimet për aftësitë luftarake, por do të jenë programe, struktura, pajisje dhe infrastruktura komplementare, kryesisht për operacionet paqeruajtëse, emergjencat civile, etj.

Në Samit, u dhanë mesazhe të qarta edhe për marrëdhëniet me Kinën si dhe mbi domosdoshmërinë kritike për zhvillimin e frymës së bashkëjetesës paqësore, Masave të Mirëbesimit Reciprok si dhe të dialogut pa kushte për paqen, vlerat demokratike dhe axhendën e integritetit Euroatlantik edhe të 6 vendeve të Ballkanit Perëndimor.

Kështu, në Samit u konfirmua se Rusia – Putiniste, e ka humbur edhe betejën për të ndezur një front të ri lufte të Kinës kundër Taivanit apo frymëzuar oscilacionet e Millosheviçit dhe ekstremistët e tipit Dodik, duke kërcënuar “me agresion ushtarak” jo vetëm sovranitetin territorial të Kosovës, por edhe prezencën e KFOR-it si dhe status quo-në dhe interesat gjeopolitike të Aleancës Euroatlantike në Rajon.

Ky është Samiti i 11-të (pas 2009) që Shqipëria ulet si anëtar me të drejta të plota në tavolinën mes të barabartëve të Aleancës Euroatlantike!

Në kapacitetin e “Ekspertit për Sigurinë Kombëtare, Rajonin, si dhe ndër kontribuuesit e udhëtimit 15-vjeçar të RSH pas anëtarësimit në NATO (2009), po theksoj se Samiti i Uashingtonit është historik edhe për RSH dhe 6 rekomandime strategjike për angazhimet e RSH përtej këtij Samiti:

Partneritet strategjik, kohezion dhe konsensus të pakushtëzuar (krah të SHBA-ve) për të gjitha vendimmarrjet, projektet dhe operacionet e NATO-s në interes të mbrojtjes kolektive (artikulli 5); mbështetjen ndaj Ukrainës si dhe rol/vend lider në promovimin e bashkëjetesës paqësore, stabilitetit demokratik, interesave gjeopolitike dhe axhendës Euroatlantike në rajon.

Të konfirmojë vullnetin politik dhe vendosmërinë e Tiranës Zyrtare për transformimin e Sistemit të Sigurisë Kombëtare, në përputhje me Konceptin e Mbrojtjes Kolektive, duke përditësuar, transformuar dhe modernizuar: konceptin, balancat demokratike të pushteteve, strukturat, pajisjet, aftësitë operacionale dhe kulturën e bashkëpunimit mes institucioneve/agjencive përgjegjëse, në interes të sigurisë së jetës, shëndetit, pronës, dhe mirëqenies së qytetarëve; promovimin e vlerave euro-atlantike; mbrojtjen e interesave kombëtare si dhe përmbushjen e detyrimeve të RSH në NATO.

Stoltenberg: E ardhmja e Ukrainës është në NATO

Në përfundim të Samitit të 75-vjetorit të NATO-s në Uashington, D.C., aleatët morën vendime për të forcuar më tej parandalimin dhe mbrojtjen, për të forcuar mbështetjen afatgjatë për Ukrainën dhe për të thelluar partneritetet globale.

Udhëheqësit aleatë u takuan me udhëheqës nga Australia, Japonia, Zelanda e Re, Koreja e Jugut dhe Bashkimi Evropian për të adresuar sfidat e përbashkëta të sigurisë dhe për të thelluar më tej bashkëpunimin. Përballë shtrirjes në rritje të Rusisë, Kinës, Iranit dhe Koresë së Veriut, NATO po punon gjithnjë e më ngushtë me partnerët në Indo-Paqësorin dhe me Bashkimin Evropian për të ndihmuar në ruajtjen e paqes dhe mbrojtjen e rendit ndërkombëtar të bazuar në rregulla. Z. Stoltenberg theksoi gjithashtu se Kina është një mundësues vendimtar i luftës së Rusisë kundër Ukrainës. Deklarata e Samitit të Uashingtonit i referohet partneritetit strategjik midis Moskës dhe Pekinit si një “shkak për shqetësim të thellë”.

Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, Jens Stoltenberg mirëpriti Presidentin Zelenskyy në një takim të Këshillit NATO-Ukrainë në Samitin e Uashingtonit, në nivel të krerëve të shteteve dhe qeverive. Sekretari i Përgjithshëm tregoi se aleatët vazhdojnë të mbështesin Ukrainën në rrugën e saj të pakthyeshme drejt anëtarësimit në NATO. Stoltenberg nënvizoi “paketën e fuqishme të mbështetjes praktike të NATO-s për Ukrainën, duke përfshirë një zotim për asistencë afatgjatë të sigurisë” të rënë dakord gjatë Samitit. “Sot, ne do të marrim vendime të mëtejshme së bashku me Ukrainën, duke e bërë të qartë se mbështetja e NATO-s është ndërtuar për të zgjatur dhe duke pohuar se e ardhmja e Ukrainës është në NATO”, - shtoi ai.

Aleatët ranë dakord të krijojnë Asistencën e Sigurisë dhe Trajnimin e NATO-s për Ukrainën, për të koordinuar sigurimin e pajisjeve ushtarake dhe trajnimin për Ukrainën. Ata njoftuan gjithashtu një zotim për ndihmë afatgjatë të sigurisë për Ukrainën me një bazë minimale prej 40 miliardë euro brenda vitit të ardhshëm. “Ky zotim do të sigurojë



ndarje më të madhe të barrës së mbështetjes ushtarake”, - tha Stoltenberg. “Ai gjithashtu do t’i sigurojë Ukrainës mbështetjen e besueshme që i nevojitet për të penguar dhe mbrojtur kundër agresionit të ardhshëm rus tani dhe në të ardhmen”. Sekretari i Përgjithshëm përshëndeti që më shumë aleatë kanë nënshkruar

marrëveshje dypalëshe sigurie me Ukrainën, duke e çuar totalin në 20. Ai gjithashtu theksoi se aleatët kanë rënë dakord të krijojnë një Qendër të Përbashkët Analize, Trajnimi dhe Edukimi NATO-Ukrainë në Poloni. Samiti i NATO-s i vitit 2025 do të mbahet në Hagë të Holandës.



Aleatët e NATO-s, Paketë Gjithëpërfshirëse të Ndihmës për Ukrainën

Mbështetja e të drejtës së vetëmbrojtjes së Ukrainës kundër agresionit të dhunshëm të Rusisë ishte një nga prioritetet kryesore për aleatët në Samitin e Uashingtonit.

Nëpërmjet Paketës Gjithëpërfshirëse të Ndihmës së NATO-s (CAP) për Ukrainën, aleatët po ofrojnë ndihmë afatshkurtër dhe afatmesme deri në afatgjatë, jo vdekjeprurëse. Që nga shkurti i vitit 2022, NATO ka ofruar ndihmën e nevojshme urgjente në shumë fusha, duke përfshirë karburantin, furnizimet mjekësore, veshjet dimërore, gjeneratorët dhe sistemet e komunikimit.

Në Uashington, krerët e shteteve dhe qeverive aleate miratuan projektet afatgjatë të CAP për rimëkëmbjen dhe rindërtimin, transformimin institucional dhe kalimin drejt ndërveprueshmërisë së NATO-s. Kjo përfshin: Mbështetje për nisjen e Qendrës së Përbashkët të Analizës, Trajnimit dhe Edukimit NATO-Ukrainë (JATEC) në Bydgoszcz, Poloni. JATEC është organizata e parë e përbashkët NATO-Ukrainë dhe një shtyllë e rëndësishme e marrëdhënieve NATO-Ukrainë. Ai do të identifikojë dhe zbatojë mësimet e nxjerra nga lufta e Rusisë kundër Ukrainës dhe do të kontribuojë në parandalimin dhe mbrojtjen e NATO-s dhe do të rrisë ndërveprueshmërinë midis forcave aleate dhe atyre ukrainase. Ministrat e Mbrojtjes aleate ranë dakord për të krijuar JATEC në Këshillin NATO-Ukrainë në shkurt 2024.

Mbështetje për përpjekjet e Ukrainës për ndërveprim. Në shtator 2023, NATO dhe Ukraina ranë dakord për një Koncept për Ndërveprim, i cili integron kërkesat e ndërveprueshmërisë në planet afatgjatë të zhvillimit të aftësive të Ukrainës. Ky udhërrëfyes, i miratuar në Samitin e Uashingtonit të vitit 2024, mbështet sektorin e mbrojtjes dhe sigurisë së Ukrainës me ndihmën e NATO-s.

Prokurimi i mbrojtjes. NATO dhe Ukraina po bashkëpunojnë për një Rishikim të përbashkët të Prokurimit Strategjik të Mbrojtjes për të harmonizuar prokurimin e mbrojtjes të Ukrainës me praktikën më të mira euro-atlantike. Kjo nismë do të ndihmojë Ukrainën të përmirësojë sistemin e saj të prokurimit të mbrojtjes dhe të promovojë efektivitetin, llogaridhënie dhe transparencë më të madhe, duke avancuar më tej integrimin e Ukrainës me NATO-n.

Paketa Gjithëpërfshirëse e Ndihmës për Ukrainën u lançua në vitin 2016 për të mbështetur aftësinë e Ukrainës për të forcuar sigurinë e saj, për të zbatuar reforma të gjera dhe për të përmbyshur nevojat imediate të Ukrainës në mbrojtjen e saj kundër luftës së agresionit të Rusisë.

Sekretari i Përgjithshëm shpall kreun e ri të Përfaqësisë së NATO-s në Ukrainë

Sekretari i Përgjithshëm Jens Stoltenberg njoftoi emërimin e një Përfaqësuesi të Lartë për të udhëhequr Përfaqësimin e NATO-s në Ukrainë (NRU). Patrick Turner do të marrë rolin në Kiev në shtator 2024. Ai ka shërbyer më parë si Ndihmës Sekretar i Përgjithshëm i NATO-s për Operacionet dhe si Ndihmës Sekretar i Përgjithshëm për Politikën e Mbrojtjes dhe Planifikimin, si dhe në një sërë postesh të larta të shërbimit civil për Mbretërinë e Bashkuar.

Sekretari i Përgjithshëm e përshëndeti emërimin: “Patrick Turner sjell vite udhëheqjeje dhe përvojë në këtë rol. Si një nëpunës publik i përkushtuar, ai ka një histori të fortë për të dhënë rezultate. Jam i sigurt se ai do të shkëlqejë në këtë rol të rëndësishëm ndërsa NATO vazhdon të rrisë mbështetjen e saj për Ukrainën”. Zoti Turner tha: “Jam vërtet i nderuar që jam emëruar si Përfaqësues i Lartë i NATO-s në Ukrainë. Mezi pres të drejtoj Përfaqësimin e NATO-s dhe të punoj shumë ngushtë me autoritetet ukrainase dhe me aleatët dhe partnerët e NATO-s për të ndihmuar në ofrimin e mbështetjes së NATO-s për Ukrainën”.

Si Përfaqësues i Lartë, z. Turner do të drejtojë NRU-në dhe do të veprojë si një pikë qendrore për angazhimin e NATO-s me autoritetet ukrainase në Kiev. Ai do të koordinojë përpjekjet e NATO-s dhe do t’i japë Aleancës vlerësime dhe këshilla për situatën në Ukrainë.

Në Samitin e NATO-s në Uashington, aleatët ranë dakord të krijojnë Asistencën e Sigurisë dhe Trajnimin e NATO-s për Ukrainën (NSATU) për të koordinuar më mirë sigurimin e pajisjeve ushtarake dhe trajnimin për Ukrainën. Kjo bazohet në mbështetjen e paprecedentë të NATO-s për Ukrainën për t’u mbrojtur kundër agresionit rus. Aleatët njoftuan gjithashtu një zotim për ndihmë afatgjatë të sigurisë për Ukrainën me një bazë minimale prej 40 miliardë euro brenda vitit të ardhshëm dhe për të siguruar nivele të qëndrueshme të asistencës së sigurisë për Ukrainën që të mbizotërojë.





Prof. Asoc. Dr. BERNARD ZOTAJ

Në rrugën e jetës drejt dijes...

Ushtaraku i lartë nga Bolena e Vlorës, Petrit Damo Mamaj na ka lënë një bibliografi mjaft e pasur. Një emër dhe një jetë e tillë e jetuar denjësisht të mbush me krenari. Ai punoi, jetoj dhe iku në përjetësi, duke na lënë pas modelin si e nisi me zell rrugën e jetës drejt dijes, kulturës e shkencës ushtarake. Jeta dhe puna e këtij ushtaraku ishte e mbushur plot surpriza, arritje shkencore e karrierë ushtarake deri në gradën e kolonelit dhe të pedagogut në Akademinë e Shtabit të Përgjithshëm, ku përgatitej “ajka” e Ushtrisë Kombëtare.

Disa nga momentet e jetës, punës dhe të detyrës ushtarake të ushtarakut Petrit Mamaj

Ai u lind, më 4 shtator 1947, në një familje bolenase, e cila ishte vendosur në qytetin e Elbasanit. Babai i tij, Damo, shquhej si njeri i mendjes. Ai ishte nga nëpunësit e vetëm të Bolenës gjatë regjimit mbretëror, një njeri korrekt e i pajisur me një kulturë të admirueshme. Mori pjesë gjallërisht në Luftën Antifashiste Nacionalçlirimtare. Pas çlirimit shërbeu oficer në Ushtrinë Kombëtare në repartet e Elbasanit dhe të Tiranës.

Prindërit, edukatën, sjelljen, kulturën dhe dijen ua transmetuan dhe fëmijëve të tyre. Petriti eci në gjurmët e babait, dhe i tejkaloi parashikimet e tij. Kreu arsimin fillor e 7- vjeçar në shkollën “Kostandin Kristoforidhi”, me rezultate mjaft të mira. Vijoi në shkollën e mesme ushtarake “Skënderbej” në vitet 1961-1965, duke e përfunduar me rezultate të larta. Ndërsa në vitet 1967-1970, përfundoi dhe Shkollën e Bashkuar të Oficerëve, duke u titulluar oficer, në rrugën që kishte bërë dhe babai i tij.

Nisi jetën e rëndësishme ushtarake duke fituar një eksperiencë në punë, duke kryer detyrat ushtarake, fillimisht në vitet 1967-1970, në Regjimentin e Artilerisë, Korpusi IX Shkodër, si komandant toge, baterie, shef zbulimi regjimenti, shef shtabi, reparti (grupi). Ndërsa në një pesëvjeçar (1970-1975) kreu detyrën e komandantit të Grupit të Artilerisë, në Br24K, në Kukës. Në vitet 1975-1977, përfundoi shkollën e Lartë të Partisë, si dhe Institutin e Lartë Pedagogjik për Histori-Gjeografi në Shkodër. Në vitet 1978-1981 kreu detyrën e komandantit të Regjimentit të Artilerisë në Korpusin V, Pukë. Ndërsa në vitin 1981 do të niste një detyrë të re, të sekretarit të komitetit të partisë, njëkohësisht dhe komisar i Br24K Kukës.

Komisari që vrojtonte, studionte dhe nxirrte përfundime

Petrit Mamaj ishte një kuadër shumë punëtor, i përgjegjshëm për detyrat që i ngarkonte funksioni i komisarit, edhe si drejtues i punës politike, edukative e kulturore, por edhe si anëtar komande. Në të dy aspektet i kishte aftësitë profesionale, sepse ishte një ushtarak i zoti dhe i kualifikuar në shkallën më të lartë. Në të njëjtën kohë ishte një punëtor politik shumë i përgatitur. Statusi i tij si një kuadër inteligjent dhe i suksesshëm në punë mbështetej në përpjekjet e vazhdueshme për ngritjen e nivelit teorik, organizativ e drejtues. Lexonte shumë. Eksperimentonte shpesh, jo vetëm në format e punës politike, edukative e kulturore, por edhe për sa i përket fushës së stërvitjes e të gatishmërisë. Ai kishte prirjen të bashkëpunonte sa më shumë me kolegët dhe me vartësit. Ishte njeri me kulturë dhe me etikë në gjithçka që bënte, në sjelljen e përditshme dhe në marrëdhënie me njerëzit, me kuadrot dhe me ushtarët.

Marrëdhëniet me kuadrot e shtabit të brigadës dhe me nënrepartet vartëse i kishte shumë të mira, një nga arsyt pse BrK në Kukës i realizonte përgjithësisht mirë detyrat në të gjitha drejtimet. Në stërvitje, në plotësimin e normave të gatishmërisë, në fortifikim, etj. Komanda e Korpusit (divizionit) shkonte shumë mirë me komisar Petritin. E vlerësonte punën dhe përpjekjet e tij, pasi ishte me laps të mprehtë, dallohej në punën e komisarit. Ishte një nga kuadrot, në mënyrë të veçantë nga komisarët, që i punonte “lapsi”. Ai kishte një përgatitje dhe arsimim të gjerë teorik dhe praktik. Ishte kuadër me nivel ushtarak, me një kulturë të gjerë politike dhe profesionale që dinte të organizonte dhe të motivonte si duhet punën politike në ushtri. Kishte aftësi të vrojtonte, të studionte dhe të nxirrte konkluzione nga puna dhe aktiviteti i përditshëm i njërive dhe reparteve ushtarake. Komisari bashkëpunonte dhe këmbente mendime me të gjithë kuadrot, me efektivin ushtar. Në kuadrin e këtij bashkëpunimi përpunonte shumë ide dhe praktika për rritjen e efektivitetit të punës politike, të punës kulturore dhe të punës së shtabit për stërvitje dhe gatishmëri luftarake.

Petrit Mamaj njihej e respektohej edhe në terren. Të gjithë kuadrot e rrethit të Kukësit, të Pukës, të Tropojës, por edhe ata të ndërmarrrjeve dhe ekonomive bujqësore, të arsimit, të kulturës, etj., e njihnin, pasi stërviteshin në repartin që drejtonte Petriti. Ai ishte punëtor e mbi të gjitha njeri me dije e me kulturë. Bashkëpunonte shumë mirë me kuadrot e terrenit. Në vijimësi punonte për përmirësimin e përmbytjes dhe të formave të edukimit politik, moral, atdhetar të efektivave, aktiv e rezervist, si kusht shumë i rëndësishëm për plotësimin e detyrave ushtarake. Me kuadrot bënte shpesh studime e sondazhe, duke iu përmbytur edhe karakterit akademik e shkencor, në lidhje

Petrit Mamaj, pedagogu që la gjurmë në historinë ushtarake shqiptare



Petrit Damo Mamaj, kolonel, Doktor i Shkencave Ushtarake, komisar i Brigadës së Këmbësisë në Korpusin Verior, pedagog në Akademinë e Shtabit të Përgjithshëm për histori e art ushtarak, redaktor i mjaft historikëve të Brigadave Sulmuese, i leksioneve shkencore në akademi dhe dekoruar me pesë urdhra dhe medalje të shërbimit ushtarak.

përvoja e luftës në Kore, në Vietnam, në katër luftërat izraelito-arabe, Irak, Ishujt Malvine etj.). Udhëheqës shkencor kishte katedrën e Historisë së Artit Ushtarak. Komisioni i posaçëm për mbrojtjen e temës kryesohej nga kryetar Kostaq Karoli dhe, më datën 28.07.1990, ky komision i dha gradën shkencore “Doktor”. Studimi i tij për luftërat lokale u thellua dhe më tej nga autori, si dhe në të gjitha kurset e Akademisë, u studiuu dhe u vendos në programin e lëndës së Artit Ushtarak. Në jetën shkencore të Akademisë, Petrit Mamaj ishte dhe anëtar i disa komisioneve për mbrojtje grade shkencore.

Me ndryshimin e sistemit e vendosjen e gradave ushtarake në vitet 1991-1993, Petrit Mamaj u emërua komandant i shkollës së mesme ushtarake “Skënderbej”

me problemet që duhet të përballonte puna edukative. Edhe për kategori të veçanta, për kuadrot, për ushtarët aktivë, për rezervistët, madje në bazë të zonave të ndryshme të kompletimit dhe të karakterit të detyrave luftarake. Fatkeqësisht, punime të tilla hulumtuese e përgjithësuese nuk ka më dhe nuk gjenden në arkiv të ushtrisë. Petrit Mamaj, veç detyrës funksionale, këto studime dhe hulumtime i kishte me dëshirë, këto bënë pjesë në formimin e tij kulturor.

Pedagogu që la gjurmë në historinë e luftërave lokale

Nga detyra e komisarit politik të BrK në Kukës, Petriti, me përfundimin e Akademisë të Shtabit të Përgjithshëm (1981-1983), me rezultate mjaft të mira emërohet pedagog i historisë së Artit Ushtarak në këtë institucion të lartë arsimor ushtarak. Në këtë detyrë punoi me shumë përgjegjësi. Ishte një punë e cila kërkonte më shumë studime njohuri të thella ushtarake në pikëpamje të programeve të përgatitjes ushtarake dhe të njohjes së thellë të parimeve të Artit Ushtarak botëror dhe shqiptar në shekuj. Në këtë institucion përpunohej mendimi ushtarak dhe bëhej përgatitjen e kuadrove të ardhshëm të lartë të ushtrisë. Akademia ishte institucioni i arsimit të lartë ushtarak, pas universitar. Akademia ishte një institucion ku duhej të aplikoheshin arritjet më të mira të shkencës, sidomos të shkencës ushtarake, të Artit Ushtarak shqiptar.

Në Akademi, përgatiti dhe trajtoi shumë tema të fushës së historisë ushtarake, shqiptare dhe asaj botërore. Në përgatitjen e Fjalorit Enciklopedik Ushtarak Shqiptarë, Petrit Mamaj ishte në redaksinë e historisë së Artit Ushtarak, ku punoi mjaft zëra të fushës ushtarake. Gjithashtu puna e tij është vlerësuar dhe si redaktor shkencor në disa nga Historikët e Brigadave Sulmuese që u punuan dhe u miratuan në sektorin shkencor të Akademisë së Shtabit të Përgjithshëm.

Në vitet 1985-1989, përveç detyrës së pedagogut dhe angazhimeve të tjera, punoi dhe për përgatitjen e temës shkencore në mbrojtje të gradës shkencore. Në këto vite punoi dhe përgatiti disertacionin me temë “Problemet e Artit Ushtarak në luftërat kryesore lokale pas Luftës së Dytë Botërore” (Nga

dhe mori gradën ushtarake “kolonel”. Ndërsa në vitet 1998-2002, kryen detyrën e shefit të Departamentit të Sociologjisë në Akademinë e Shtabit të Përgjithshëm, ku dha një përvojë mjaft të dukshme në leksionet e përgatitura të ndryshuara dhe të përshtatura me kushte e reja të luftës.

Dr. Petrit Mamaj ishte njeri nga ushtarakët më në zë në brezin e ri të Luftës së Ftohtë, duke dhënë kontribut në mjaft leksione, biseda e studime në rangje të larta të Ushtrisë Kombëtare, por dhe të kërkimit shkencor. Arti ushtarak shqiptar ka edhe mendimin e intelektualit nga Bolena. Kontributi i tij është vlerësuar me disa dekorata e urdhra pune. Emri i tij gjendet në enciklopedinë e Bolenës, të Kurveleshit dhe të Fjalorit Enciklopedik Ushtarak Shqiptar, duke ngjallur simbol i përkushtimit ndaj detyrës ushtarake, por edhe i një pune këmbëngulëse në arritjen e dijes dhe të shkencës ushtarake.

Në të gjithë punën dhe jetën e tij, Petrit Mamaj ishte një njeri i qetë, korrekt, komunikues, si dhe i pajisur me kulturë të gjerë qytetare. Ai edhe pse ishte lindur larg vendlindjes së tij, mbante lidhje me bashkëfshatarët dhe njerëzit e Bolenës. Për këto cilësi dhe vlera njerëzore në vitin 2013, u zgjodh nga gjithë komuniteti bolenas, kryetar i Shoqatës Kulturore Atdhetare “Bolena” me qendër në Tiranë. Ai u shfaq në të gjithë veprimtarinë e tij si një kuadër, intelektual e njeri me vlera të spikatura kulturore, shkencore e shoqërore.

Bashkë me bashkëshorten Tefta (me arsim të lartë për farmacistë), si dhe me tri vajzat shembullore (edhe këto me arsim të lartë) ishin një derë e hapur, një derë mikpritëse, kudo ku punoi dhe shërbeu në skajet veriore të vendit. Familja Mamaj kishte miqësi e shoqëri me të gjithë të njohurit, por edhe me ata që njohu në jetë në zonat veriore të vendit. Të gjithë kishin shumë nevojë për njeri-tjetrin në ato vite të punëve të mëdha, por edhe të privacioneve po aq të mëdha që detyronte jeta ushtarake në zonat e vështira ku punoi dhe jetoj së bashku me familje, ushtaraku model, që iku nga jeta ditën e ushtrisë.

Njeriu dhe ushtaraku i mirë Petrit Mamaj do të kujtohet në brezat e ushtarakëve si studiuesi që la gjurmë në studimin e luftërave lokale të pas Luftës së Dytë Botërore.

Veshja e gruas mirditore, pasuri kombëtare

Veshja e gruas mirditore e mbushur me simbole mitike dhe kulti, është shpallur “Kryevlerë Kombëtare e Trashëgimisë Kulturore Jomateriale”.

Veshja e Gruas së Mirditës është një nga objektet më unike të trashëgimisë jomateriale, e cila mbart elementë autentikë kulturorë etnografikë, sikurse krahina e Mirditës.

Dëshmitë e para të krijimit të kësaj veshjeje vijnë nga Mesjeta, por në qëndisimat e gunës (xhupit) të gruas mirditore janë të ruajtura shumë simbole mitike dhe kulti që i përkasin kulturës së hershme iliro-arbërore.

Sipas studimit të akademikut Mark Tirta “në gunën e trevës së Mirditës, Pukës, Lezhës, Krujës, Matit, ndeshet dendur simboli i diellit në formë kryqi, në ngjashmëri me svastikën, rrathë koncentrike, elementë këta të kulturës ilire. Pjesët e veshjes përbëhen nga 14 elementë tradicionale”.

Shtirja gjeografike e përdorimit të kësaj veshjeje përfshin gjithë krahinën e Mirditës që ndryshe quhen 12 katundet e bajrakëve (flamujve): Oroshi, Spaçi, Kuzhneni, Dibri, Selita, Kthell, Rraza, Kryezezi, Bulgri, Vela dhe Manatia. Veshja etnografike e Mirditës është përdorur edhe nga gratë katolike në Luzë e në zonën e Kurbinit.

Veshja mirditore përmendet për herë të parë në vitin 1610 në një relacion të Argjipeshkvit të Tivarit, dhe më pas në fund të shek. XIX nga studiuesi dhe konsulli francez në Shkodër Alexandre Degrande, në librin e tij “Kujtime nga Shqipëria e Epërme”.



Veshja mirditore përmendet edhe në kujtimet e Edith Durham, si dhe nga studiues dhe udhëtarë të tjerë të kohës.

Një vlerësim maksimal për këtë veshje ka bërë etnologia franceze, Jacqueline Benezech në vitet '30, e cila pas një udhëtimi studimor citon: “Vështirë të imagjinoja kostum më hijerëndë dhe njëkohësisht më të jashtëzakonshëm nga bukuria dhe me një prerje aq mjeshtërore....”.

Në Mirditë dhe në Alpet e Shqipërisë (në zonat e besimit katolik) ka një karakteristikë të veçantë, sepse në veshjet e tyre lexohet hershmëria, origjina më e pa kontaminuar në krahasim me zonat që ndërjuan fenë. Etnografja e njohur thekson faktin se faktet historike për mënyrën si visheshin shqiptarët i përkasin shekullit XIV-XV, pikërisht kur Shqipëria ishte e ndarë në principata. Periudha e feudalizmit solli formimin e një fytyre të re të të gjitha krahinave shqiptare dhe jo vetëm Mirdita, po kjo është periudha kur krahinat filluan të formojnë identitetin e tyre. Elementet më të hershme të kostumit mirditor janë këmisha e gjatë si për burra dhe për gra dhe dollamet që ishte si një pallto e hapur me mëngët dekorative që varen.

Ka qenë një këmishë e rrudhur që krijonte imazhin e fustanellës. Kjo ka qenë veshja në fazën më të hershme. Tek gratë kemi llahengën ose xhupen.

Në veshjet e Mirditës një vëmendje e veçantë merr pjesa e gjoksit, sepse aty gjejmë një minierë. Këmisha dekorohet në mënyrën më elegante, më interesante, me një fill të hollë dhe shkëlqyes që dallohet me finesë dhe tregon fisnikëri të veçantë. Element tjetër i hershëm dhe dallues për kostumin mirditor është brezi me rrema, një brez që varet nga prapa dhe një përparje e vogël që quhet stravec.

Tek dekori i xhupes ose llahengës, lexohet krishterimi i



hershëm, i stilizuar me lloj-lloj formash, ndonjëherë të fshehta dhe ndonjëherë të hapura. Ka një simbolikë në xhuben e grave të Mirditës që ngjan, sipas studiuesve të ndryshëm, herë në formën e një njeriu e herë në formën e shqiponjës.

Në fshatrat e Shqipërisë së Veriut përpunimi i shqiponjës është një motiv i veçantë. Shqiponja ka qenë e adhurar dhe këtë e shohim jo vetëm në tekstile dhe veshje, por dhe në dru është si një shpend totem me forcën dhe lirinë e saj që gjithnjë i ka mrekulluar shqiptarët. Ndaj është ky adhurim që ajo të përdorej gjerësisht në folklorin shqiptar.

Frizura mbretërore e grave mirditore

Elemente të tjera dalluese që e bëjnë të veçantë gruan mirditore është frizura e grave. Është e jashtëzakonshme. Mënyra e krehjes së flokëve tek gratë mirditore me të cilën tregojnë moshën dhe statusin e tyre, si dhe mënyra se si e lidhin shaminë është shumë treguese. Është një stil i mbretëreshave të kohës, si përëndeshat e kohës ilire.

E veçantë është se nuset e reja përdorin një kësulë të veçantë me stringla. Në fakt ky është një ndikim i kulturave të huaja lindore. Dhe kjo është normale. Ka ardhur nga emigracioni, nga fakti që Shqipëria ka qenë e pushtuar për një periudhë të gjatë nga pushtuesit e huaj dhe patjetër që ka ndikuar dhe tregtia. Veshjet e dasmave gjithnjë kanë pasur ndikime të mëdha nga kulturat e huaja. Një gjë tjetër shumë specifike e veshjes së Mirditës janë çorapet e grave. Si askund tjetër, në asnjë krahinë të Shqipërisë, ato kanë një formë vezake. Diametri i tyre shkon 33-34 centimetra. Të gjitha zonat i kanë çorapet e ngushta ndërsa mirditorët i kanë shumë të gjera. Madje, dhe në zonat rreth e rrotull që përdorin këtë model çorapësh i quajnë me emrin iltinka. Një gjë karakteristike e tyre janë motivet që përmbajnë. Në motivet e çorapeve gratë e krahinës derdhin gjithë krijimtarinë e tyre.

Një nga tiparet më karakteristike të grave mirditore është shamia e zezë. Thuhet se dikur shamia dhe xhaketa e grave mirditore ka qenë e bardhë, por pas vdekjes së Skënderbeut për shkaqe zie u bë e zezë.

Mirdita dhe veshjen e burrave e ka shumë interesante. Edhe ajo në kohën më të hershme ka qenë e përbërë nga këmisha e



gjatë dhe me një kësulë shumë të veçantë. Mirditorët dallohen nga qelshja e tyre, e cila ka një formë të prerë konike. Vetëm në shekullin e 19-të, burrat mirditorë filluan të mbajnë tirqe, por shumë të zbuluar me gajtanë të zi të leshtë. Më pas kemi ardhjen e jelekëve të kuq në vishnje që erdhën si ndikim nga qyteti i Shkodrës. Dhe në fund të këtij këndvështrimi mbi veshjet popullore të Mirditës, sipas etnografes së njohur, duhet dalluar diçka shumë e rëndësishme se edhe me ardhjen e modës evropiane vihet re se një numër i madh grash të kësaj zone e ruajnë veshjen e tyre karakteristike dhe mbi të gjitha ruajnë frizurën interesante që i bëjnë ato, ndër më të veçantat e Shqipërisë.


Prova të jetës aliene shumë shpejt...

Teleskopi Hapësinor “James Webb” i NASA-s ka qenë në funksion vetëm për pak më pak se dy vjet, por shkencëtarët tashmë po shohin pajisjen e tyre të ardhshme të gjuetisë jashtëtokësore.

Dhe tani, një astrofizikan që punon me agjencinë hapësinore amerikane në kërkimin e ekzoplaneteve të ngjashme me Tokën, ka deklaruar se teleskopi i ri i planifikuar i NASA-s, “Observatori i Botëve të Banueshme” (HWO), mund të gjejë prova të jetës aliene ‘në jetën tonë’.

Tre kontrata të NASA-s me vlerë 17.5 milionë dollarë do të hyjnë në fuqi këtë verë, duke ndërtuar pajisjen e gjeneratës së ardhshme të HWO dhe kodin e nevojshëm për të tërhequr një ditë të dhënat e ekzoplaneteve të afërta me detaje të reja.

Por në 15 vitet para se HWO të dalë në internet, ka të ngjarë të përballlet me shumë konkurrentë, si ata që argumentojnë se jeta aliene tashmë është gjetur në ekzoplanetin K2-18b.



Një model i pamjes së përparme të pasqyrës së koleksionit të dritës dhe EMF të HWO

Ndërsa shkencëtarët debatojnë të dhënat e “James Webb-it” për K2-18b – duke përfshirë kërkimet e reja në “Astrophysical Journal Letters” që sugjerojnë se çdo ‘biosfirmë’ e supozuar nga planeti jashtë botës është e tepruar – rrjeti i NASA-s vazhdon të hartojë strategji se si HWO mund të sigurojë më së miri prova përfundimtare të ET.


Ekipi i ekzoplanetëve të agjencisë hapësinore prej astronomësh, fizikanësh, inxhinierësh dhe shkencëtarësh u takuan janarin e kaluar në New Orleans për të shqyrtuar mjetet e nevojshme për këtë punë.

Astronomi i Berkeley, Dr. Courtney Dressing, një bashkë-udhëheqës i Ekipit të Rishikimit të Arkitekturës Shkencore (START) të HWO-së, propozoi krijimin e HWO me kapacitetin për të zbuluar një “larmi të gjerë bio-gjurmësh”.

Të ashtuquajturat gaze “biogjene”, të prodhuara nga organizmat e gjallë; aerosolet dhe ndotësit e tjerë të ajrit; “Biogjurmët sipërfaqësore”, si nxehtësia me rreze infra të kuqe të prodhuar nga bimësia, dhe më shumë “teknofirma” artificiale që do të bëheshin nga një racë e civilizuar aliene, të gjitha “mund të zbulohen me HWO”, vuri në dukje Dr. Dressing.



Fokusi i teleskopit hapësinor “Hubble” në dritën vizuale kapi shumë më tepër nga yjet më të vjetër, më të kuq të një galaktike dhe yjet më të rinj, më blu (majtas). Por sensorët me rreze infra të kuqe në “James Webb” më të ri, u treguan më të mirë në imazhin e masave të gazit dhe pluhurit që lundronin lirshëm përgjatë krahëve spirale të një galaktike, si dhe në kapjen e një paraqitjeje të thellës së dendur galaktike të sistemeve yjore (djathtas). Në imazhin e mesit, një pamje e kombinuar e sensorëve të të dy teleskopëve.



Astrofizikani Jessie Christiansen, i cili punon me NASA-n në kërkimin e ekzoplaneteve të ngjashme me Tokën, ka thënë se teleskopi i ri i planifikuar i agjencisë hapësinore amerikane, Observatori ‘Habitable Worlds’ (koncepti më lart), mund të gjejë prova të jetës aliene ‘në jetën tonë’

Por, për të bërë më mirë se analiza K2-18b, e “James Webb”, për shembull, arkitektëve të HWO do të duhet të dalin me shenja edhe më të testueshme të jetës.

“Informacione shtesë rreth planetit dhe sistemit planetar, - tha Dr. Dressing, - do të kërkohen për të interpretuar gjurmët biologjike dhe për të përjashtuar pozitivet e rreme”.

Megjithatë, një astrofizikan që shërben si kryeshkencëtar për Institutin e Shkencës Ekzoplanete të NASA-s në “CalTech”, Dr. Jessie Christiansen, beson se HWO mund të gjejë prova të jetës jashtëtokësore jo shumë kohë pasi të jetë nisur në 2040.

“Unë besoj, ‘gjatë kësaj jete’, diçka si HWO do të shohë një sinjal në atmosferën e një planeti shkëmbor në zonën e banueshme të një ylli si dielli ynë që ne mendojmë se është jetë, - tha Christiansen për “New Scientist”.

“Ne po dalim me pyetje shkencore, të cilave do të donim që teleskopi t’u përgjigjej”, - shpjegoi Dr. Christiansen.

Mbledhja e spektrit elektromagnetik nga jashtë spektrit të dritës së dukshme, si drita infra e kuqe dhe UV, madje edhe rrezet x, është një metodë që përdorin astronomët për të kuptuar më mirë

se çfarë është atje në univers.

Përqendrimi i teleskopit hapësinor “Hubble” në dritën vizuale kapi shumë më tepër nga yjet më të vjetër, më të kuq dhe yjet më të rinj, më blu të një galaktike, për shembull.

Por sensorët me rreze infra të kuqe në “James Webb” më të ri, u treguan më të mirë në imazhin e masave të gazit dhe pluhurit të lirë që notonin përgjatë krahëve spirale të një galaktike, si dhe mundën të kapnin një paraqitje të shkurtër të bërthamës së dendur galaktike të sistemeve yjore.

“Ne kemi qenë në gjendje t’i shikojmë yjet me një saktësi të tillë dhe instrumente kaq të hollë që mund të shohim planetë rreth tyre”, - vuri në dukje Dr. Christiansen. “Tani, ne e dimë se ka mijëra planetë, dhe shumica e yjeve kanë planetë”.

Por, pavarësisht mbi 5,000 ekzoplaneteve të reja të regjistruara dhe disa dhjetëra kandidatëve të ngjashëm me Tokën, ajo shtoi: “Ne ende nuk kemi gjetur një planet si Toka, një planet shkëmbor në një zonë të banueshme të një ylli si dielli”.

Kontraktorët ushtarakë “Northrop Grumman”, “Lockheed Martin” dhe “Ball Aerospace” (BAE Systems) do të fillojnë pjesën e tyre të punës në HWO këtë verë, sipas NASA-s.

Përpjekja dyvjeçare dhe 17.5 milionë dollarë e kompanive do të përfshijë ndërtimin e sistemeve të sensorëve optikë ‘ultra-stabilë’, të cilat NASA shpreson se do të jenë ‘përtej teknologjisë aktuale të nivelit të lartë’ për të ndihmuar në mbajtjen e projektit të tyre HWO në orbitë, sa më gjatë.

Kontributi i “Northrop Grumman” në këtë përpjekje do të jetë një mbështetje mbrojtëse për trenin optik të teleskopit, i cili ata shpresojnë se mund të sigurojë që HWO t’i rezistojë ngjarjeve të papritura në mjedisin e ashpër të hapësirës.

Megjithatë, shpenzimet e këtij viti nuk janë asgjë në krahasim me 11 miliardë dollarë në total që NASA shpreson se qeveria e SHBA-ve do t’i kushtojë teleskopit të saj HWO.

Deri në fund të misionit të tij zyrtar, i cili do të fokusohet në imazhin e drejtpërdrejtë të të paktën 25 kandidatëve kryesorë për botët potencialisht të banueshme, Dr. Christiansen pyet veten nëse njerëzimi do të jetë ndonjëherë i njëjtë.

“Mund të fillojë një revolucion në jetë, fe, filozofi dhe shkencë”, - tha ajo, megjithëse astrofizikani rrëfeu se reagimi i publikut mund ta befasojë atë.

“Mund të jetë një titull për një ditë, - pranoi ajo, - dhe pastaj të gjithë kthehen në rutinën e tyre të përditshme”.

Avionët luftarakë të gjeneratës së 6-të të Evropës përmirësohen me krahë të dronëve të fuqizuar me AI

Sipas “Airbus”, FCAS do të përqendrohet rreth një sistemi bërthamor të gjeneratës së ardhshme të armëve (NGWS). Inteligenca artificiale (AI) mund të luajë një rol jetik në Sistemin Ajror Luftarak të Ardhshëm që po zhvillohet nga konsorciumi i Gjermanisë, Francës, Spanjës – të cilit Belgjika i është bashkuar si vëzhgues.

FCAS është një përpjekje e vendeve evropiane për të vendosur një numër avionësh luftarakë dhe dronësh deri në vitin 2040.

Konsorciumi gjithashtu ka një qëllim për të marrë demonstruesin e parë të mundshëm në ajër deri në fund të vitit 2030.

Sipas një raporti, AI po luan një rol kritik në zhvillimin e sistemeve të ndryshme nën programin FCAS dhe gjithashtu do të ndikojë në mënyrën në të cilën operon avioni përfundimtar dhe si do të funksionojnë pilotët e tij.

Programi FCAS i Evropës dhe roli i AI-së

Një nga diferencuesit kryesorë të FCAS është se avioni kryesor i platformës do të përdorë krahë të dronëve për t’iu përshtatur qëllimeve të ndryshme.

Krahët e dronëve mund të marrin përsipër përgjegjësi të ndryshme, duke mbledhur të dhëna, duke shtuar aftësitë e zjarrit të luftarakut, ndër të tjera. Këta krahë, sipas kompanive që qëndrojnë pas projektit, do të duhet të kenë disa aftësi vendimmarrëse autonome për të pakësuar barrën e pilotëve.

Një raport në “Defense News” thotë se ndërtimi i këtij lloji të AI-së do të jetë vendimtar për suksesin e projektit FCAS në tërësi.

Raporti vazhdon më tej, duke cituar Onur Deniz, CEO i kompanisë NeuralAgent, i cili është ngarkuar të sigurojë që procesi i shkëmbimit të të dhënave të mbetet konstant në aeroplanët dhe dronët e platformës FCAS.

Sipas tij, ata po marrin një qasje që do t’i lejojë krahët e dronëve të marrin vendime autonome vetë, në vend që t’i marrin ato nga një komandë e centralizuar. Për më tepër, ata gjithashtu do të jenë në gjendje të transmetojnë vazhdimisht të dhëna me kolegët e tyre dhe qendrën e komandës.

Kompania gjithashtu ka kryer teste simulimi me krahët e dronëve, duke përdorur këtë qasje dhe ka treguar rezultate shumë pozitive, me 95% sukses në situata të ngjashme me luftën.

“Deri në fund të vitit 2025, softueri do të jetë gati për integrim në harduerin ekzistues – sistemet e trashëgimisë, fillimisht”, - thotë Deniz sipas raportit.

Programi dhe qëllimet e tij përfundimtare

Sipas “Airbus”, FCAS do të përqendrohet rreth një sistemi bërthamor të gjeneratës së ardhshme të armëve (NGWS). Në këtë “sistem sistemesh”, luftëtarët e gjeneratës së re të pilotuar do të punojnë së bashku me transportuesit në distancë pa pilot - të gjitha



të lidhura me sisteme të tjera në hapësirë, në ajër, në tokë, në det dhe në hapësirën kibernetike nëpërmjet një reje të dhënash të quajtur “Cloud luftarakë”.

FCAS është një hap më shumë drejt synimit për arritjen e një lufte të plotë bashkëpunuese deri në vitin 2040, e cila mund të zëvendësojë sistemet ushtarake si “Rafale” dhe “Eurofighter”.

“Airbus” thotë se një shtrirje në rritje e aftësive FCAS është planifikuar duke zbatuar ndërgjegjësimin fillestar të situatës në të gjithë aftësitë e platformës në mesin e viteve 2020.

“Kjo mund të pasohet në vitet 2030 nga një ekip pa pilot midis

luftëtarëve ekzistues të përmirësuar, si “Eurofighter Long Term Evolution” (LTE) me një kabinë dhe lidhje të përmirësuar, sensorë dhe armë të reja dhe transportuesit në distancë të gjeneratës së parë, përpara arritjes së një Vizioni të plotë të FCAS në 2040 me Sistemin e Armëve të Gjeneratës së ardhshme si thelbin e tij.”

Transportuesit në distancë do të lirohen nga avionët e transportit si A400M i “Airbus” për të ndihmuar avionët e drejtuar që do të luajnë rolin qendror.

Megjithatë, transportuesit në distancë do të funksionojnë me një nivel të lartë autonomie dhe për këtë AI do të jetë një faktor kyç.

Robotët do të përbëjnë një të tretën e forcave ushtarake amerikane deri në vitin 2039

Robotët dhe makineritë inteligjente do të përbëjnë një të tretën e ushtrisë amerikane në 10-15 vitet e ardhshme, sipas gjeneralit të ushtrisë në pension, Mark Milley. Një e treta e ushtrisë amerikane mund të jetë robotike në 15 vitet e ardhshme, pohoi gjenerali Mark Milley, një ish-kryetar i Shefave të Përbashkët të Shtabit.

Miratimi i gjerë i mjeteve të luftës pa pilot dhe të drejtuar nga AI-ja do të riformësonte ndjeshëm ushtrinë, duke ngritur pyetje serioze etike. Sipas Milley, do të jetë një ndryshim thelbësor dhe ai argumenton se ushtritë e kombeve të tjera do të jenë të dizajnuara në mënyrë të ngjashme.

Përparimi i teknologjisë ushtarake me dronë të armatosur dhe qen robotë

Forcat ushtarake globalisht po konkurrojnë për të avancuar teknologjitë robotike që ndihmojnë në luftime, mbledhjen e inteligjencës, evakuimin e viktimave, transportin dhe detyra të tjera kritike në tokë, ajër dhe ujë.

Inovacionet kanë prezantuar një sërë teknologjish të avancuara si dronët e armatosur dhe qentë robotë, të cilat tani janë më të zbatueshme se kurrë falë përparimeve në industrinë e mbrojtjes dixhitale.

Ushtria po teston në mënyrë aktive formacionet e integruara njeri-makinë, ku ushtarët bashkëpunojnë me automatikë në skenarë luftimi. Ndërkohë, Forcat Ajrore po ndjekin avionë “luftarakë bashkëpunues” të krijuar për të fluturuar së bashku me pilotët njerëzorë. Këta avionë synojnë të mbledhin inteligjencë, të prishin elektronikën e armikut dhe të ekzekutojnë goditje precize mbi objektivat.

Milley vuri në dukje se zhvillime të tilla përshkruajnë disa nga ndryshimet më të mëdha në karakterin e luftës.

“Dy zhvillimet e mëdha që po shfaqen shumë shpejt është prezantimi i robotëve...e kombinuar me fuqinë e madhe të llogaritjes kuantike dhe AI-në, dhe do të kemi disa ndryshime thelbësore vërtetë të rëndësishme”, - tha ai gjatë ngjarjes.



Ndërkohë, Marina po përparon drejt një flote hibride, duke integruar mjete sipërfaqësore dhe nënujore pa pilot për të rritur aftësitë e marinarëve dhe marinsave. Marina po e bën këtë me ndihmën e

se vendi që optimizon këto teknologji për përdorim ushtarak mund të fitojë një avantazh të rëndësishëm, dhe potencialisht vendimtar, në konfliktet e armatosura.

pionierëve të tillë si Task Force 59 në Lindjen e Mesme, të cilët janë në krye të inovacioneve të tilla.

Mbikëqyrja njerëzore në kontrollin e këmbëzës dhe robotika e gjithanshme në operacionet ushtarake

Politika e SHBA-së mandaton kontrollin njerëzor mbi mekanizmat nxitës. Robotika gjithashtu shërben për qëllime më të gjera, të tilla si transportimi i furnizimeve në distanca të gjata ose evakuimi i luftëtarëve të plagosur nga fusha e betejës.

Ndërsa kombinimi i tankeve pa ekuipazh ose avionëve luftarakë pa pilot me softuer vendimmarrës ultra të shpejtë ngre shqetësime për robotët vrasës, ekzistojnë disa masa mbrojtëse që zbatohen.

“Unë mendoj se kjo do të jetë diçka me të cilën njerëzit do të duhet të kuptojnë këtu në dekadën e ardhshme”, - komentoi Milley në lidhje me mbikëqyrjen e armëve. Megjithatë, ai theksoi gjithashtu

AT SHTJEFËN GJEÇOVI – KRYEZIU, DËSHMOR I GJUHËS SHQIPE




Prof. Asoc. Dr. Zaho GOLEMI

Me rastin e 150-vjetorit të lindjes së kolosit të Atdheut, Shtjefën Gjeçovit (12.7.1874 – 14.10.1929), dëshmorit më të ri të kombit shqiptar të shpallur me vendim nr.850 datë 21.6.2021, të Komisionit Qendror të Statusit “Dëshmor i Atdheut”, pranë Ministrisë së Mbrojtjes. Shtjefën Gjeçovi është cilësuar një “makinë intelektuale” enciklopedike, që na ka lënë një trashëgimi të shkruar prej më shumë se dhjetëmijë faqesh, i cili njihet tetë gjuhë të huaja, që konsiderohet “Instituti shkencor gjeçovian”. Përjetësi dhe pavdekësi për dëshmorin e atdheut, dëshmorin e gjuhës dhe kulturës shqipe Shtjefën Gjeçovi!

Vatër atdhetarie që lindi një meteor të shquar të shqiptarizhmës

Shtjefën Gjeçovi, lindur dhe pagëzuar si (Mëhill) Hilë Gjeçi në Janjevë (Kosovë), më 12 korrik 1874, dhe i ekzekutuar nga dora gjakatare serbe në Zym të Hasit të Thatë, më 14 tetor 1929, ka qenë frat françeskan, arsimtar, mbledhës folklori, arkeolog, publicist shqiptar dhe mbi të gjitha përhapës i arsimit dhe gjuhës shqipe. Ai u shqua për punën e madhe kërkimore të mbledhjes së traditave dhe mënyrës së jetesës të shqiptarëve të veriut dhe veçanërisht për kodifikimin e përmbledhjeve të lëndës kanunore të Kanunit të Lekë Dukagjinit. Veprimtaria e tij mbuloi gjithashtu përpjekjet e kohës për afrimin e Kishës Katolike me Uniatizmin dhe Kishën Ortodokse shqiptare, si dhe ka qenë pjesë e intelektualizmit përparimtar shqiptar kudo ku e kërkonte dhimbja therëse e Atdheut. Të dhënat bibliografike flasin se Hilë Gjeçi ka për origjinë Kryeziun e Pukës, Janjevën e Vilajetit të Kosovës, në kohën e Perandorisë Osmane. Trualli atdhetar dhe të parët, të zgjuar prej natyre e bënë Mëhillin një fëmijë tepër të zgjuar. Duke e parë këtë gjendje famullitari françeskan i Janjevës, u mori leje prindërve, dhe e mori një ditë për dore Shtjefënin 10 vjeçar dhe u nis bashkë me të për në Kolegjin françeskan që ndodhej në Shkodër. Kur i veshën zhgunin e murrme, të fratit iu duk vetja më i rritur dhe më i burrrëuar. Arsimimin françeskan e mori në Troshan (1884-1888). Më 16.8.1888 u nis në kuvendin e Fojnicës për vitin e rishtarisë dhe vijoi studimet më tej në Derventë dhe Banja Luka, por ndoqi mësimet edhe në Kreshevë. Në këtë periudhë Bosnjë-Hercegovina ishte trualli ku përgatiteshin një pjesë e konsiderueshme e françeskanëve shqiptarë, në të njëjtin vend ku u arsimua edhe Gjergj Fishta. Studimet e tij vijuan deri në vitin 1896, kur edhe kthehet në atdhe dhe meshon për herë të parë në Troshan, vit që ndërron emrin dhe në regjistrat françeskanë quhet: Shtjefën Kostandin Gjeçovi. Shërben si famullitar në Rubik; në verën e 1897 në Pejë, ku emërohet famullitar në Zllakuqan, vendi që në korrik hap shkollën e parë. Nga 1899 deri më 1905 shërben në famullinë e Laç-Sebastes, ku rihap shkollën shqipe në Laç. Lidh shoqëri të ngushtë me Konicën dhe përmes tij siguron materiale mësimore për nxënësit. Në fund të dhjetorit 1905 punësohet mësues në Kroaci (Borgo-Erizzo), ku zëvendëson Pashk Bardhin, por dorëhiqet dhe pas disa muajsh është aktiv dhe merr pjesë në Kuvendin e Bajrakut të Kurbinit. Përfjeton me gëzim pavarësinë e 28 nëntorit 1912 në Vlorë. Më tej është pjesëmarrës me krerët e Pukës, Mirditës, Zadrimës e Lezhës, në kuvendin e 7 korrikut 1913 në Lezhë.

Vitet që pasuan emërohet në Troshan (1915) dhe pas një viti, më 1916, në Theth, Shalë e Shosh, ku kolera kishte pllakosur zinë e pandemisë dhe vdekja ishte fare pranë jetëve njerëzore. Në kohën e pushtimit austro-hungarez punon në Prekal dhe shtëpia ku



u vendos banohej edhe nga komanda lokale austro-hungareze. Në shtator 1917 u jep mësim fëmijëve shqiptarë në dhomën-shkollë ku banonte, për 26 nxënës djem paradite dhe 11 nxënëse pasdite, mësimdhënie që e kërcënuan me ndalim veprimtarie si mësues, duke e kushtëzuar furnizimin material me fenë. Pranvera e vitit 1920 e gjen Shtjefën Gjeçovin në kishën katolike të Vlorës, ku takohej shpesh te Dom Mark Vasa, që kishte marrë mërinë e autoriteteve italiane. Bëhet njësh me patriotët më të zjarrtë të krahinës së Vlorës dhe merr pjesë në takimet për çlirimin e Vlorës nga pushtuesit italianë. Gazetat “Politika”, “Mbrojtja kombëtare”, “Drita” e cilësojnë Shtjefën Gjeçovin si “luftëtar i Njëzetës”, si mbrojtës të komunitetit vlonjat në periudhën e luftës, si hulumtues dhe njohës të traditave të Labërisë dhe të përbashkëtat zakonore të të gjithë shqiptarëve. Pjesëmarrës në të gjithë aktivitetet e komisionit organizator të fitores së Luftës së Vlorës. Më 7.6.1923 emërohet sekretar i Provincës Françeskane. Pas një viti, më 1924, gjendet në krahinën e Elbasanit, ku gjatë verës bashkë me Simon Shuteriqin zbulon në kishën e Shën Kollit të qytetit të Elbasanit kamanën e Sopotit të Bërzeshtës, që datonte që nga koha e Gjergj Aranitit. Më 1926 emërohet në famullinë e Zymit të Hasit të Thatë, ku aktivitetin e zhvillonin edhe në Pejë, Gjakovë e Prizren. Dora gjakatare ngrihet kundër At Shtjefën Gjeçovit 55 vjeçar, në vendin e quajtur Kodër Rrezina më 14.10.1929, duke i marrë jetën qarqe antishqiptare, por që nuk mundën të vrisnin idealet e tij patriotike atdhetare të shqiptarizhmës dhe përhapjes së kulturës kombëtare shqiptare. “E keqja”, që kishte bërë Gjeçovi është se për gjashtë muajt e

fundit të jetës kishte punuar në Zym nga prilli deri më 14 tetor, ku u mësonte gjuhën shqipe fëmijëve dhe të rriturve, pa marrë parasysh se cilit besim i takonin. Pëllëmba për mësuesin serb të mbretërisë serbo-kroate sllovene paguhej me plumb. Mësuesi i Kombit Shtjefën Gjeçovi është varrosur në Shëngjergj afër Zymit të Hasit. Në Zym të Hasit të Thatë gjendet qendra memoriale ndërtuar në nderim të tij.

Shtjefën Gjeçovi, përmendore e mençurisë shqiptare

Në memorien e kombit shqiptar është regjistruar një emër i shndritshëm dhe meteor i kulturës dhe gjuhës shqipe. Gjeçovi paralelisht me detyrimet e besimit për meshën, ai mbledhi si “zog pule i uritur”, traditat e Shqipërisë Veriore, të rrafshit të Mirditës dhe Alpeve Shqiptare, poezinë popullore të malësive, zakonet e të drejtës popullore dhe lëndë etnografike, por edhe arkeologjike. Ai i raportoi rregullisht kërkimet e tij, duke botuar materiale etnografike, arkeologjike dhe histori lokale nëpër të përkohshme të kohës. Ai ka qenë i pari folklorist shqiptar që ndërmori punë kërkimore në terren sipas kriterëve metodologjike të kohës. Përvoja e tij zë fill në periudhën studentore në Bosnje me një punim historik mbi Arqipeshkvinë e Tivarit bashkautor me sivëllain Lovro Mihaçević, duke punuar të paktën gjashtëmbëdhjetë faqet e para me titullin në latinisht “Metropolis Antibarensis”. Botimet e para të Shtjefën Gjeçovit janë dymbëdhjetë poezi tek gazeta “Albania” e Faik Konicës me emër pende “Lkëni i Hasit”. Fakt është se punimi më i rëndësishëm i jetës së tij që përmbledhja e kodit zakonor shqiptar, botimi i të cilit u titullua “Kanuni i Lekë Dukagjinit.



Mbledhjet e para të kanunit i botoi në vitet 1898-1899, tek gazeta “Albania” e Faik bej Konicës, më 1897-1898, dhe më pas tek “Hylli i Dritës” në vitet 1913-1924, ndërkohë që përmbledhja e plotë ka 1263 nene, të renduara në 12 kapituj, dhe që u botua nga françeskanët së pari, më 1933, vetëm pas vdekjes së tij, ose më qartë dhe më saktë pas vrasjes së tij. Metoda se si u bë mbledhja nuk është bërë tashmë e njohur për publikun, ndërkohë që vepra e Gjeçovit ndriçon si pishtarë i përjetshëm, për vlerën e madhe që kishte për dje, për sot dhe për të nesërmen e shqiptarizmsë.

Kompletimi me arsimim i françeskanëve në Austri dhe Italisë e zgjeroi dritën e dijes por edhe interesimin e Gjeçovit për historinë e shqiptarëve dhe vendin e popullit të tij krahas civilizimeve të tjera ballkanike e europiane, për fillimet e krishterimit, për arkeologji, etnografi, gjuhësi e letërsi. Provoi të shkruante vetë dhe të thellohej në shkencat humane, krahas detyrimeve që rrjedhin nga predikimi i Ungjillit të Krishtit. Në moshën 22 vjeçare më 1896, kur u kthye në Troshan si famullitar i ri i pajisur me dije të thella me kulturë të gjerë, por edhe energji të shumta, krahas zhgunit të murrme të fratis fitoi aftësinë e mësimdhënies, aftësi që do ta vinte në veprim në interes të përhapjes së gjuhës dhe kulturës shqiptare. Shtjefën Gjeçovi predikoi ungjillin në Rubik, Pejë, Laç-Sebaste, Zarë, Sapë, Theth, Prekal, Vlorë, Shkodër, Gjakovë e Zym të Hasit (për kohën rrethinë e Prizrenit). Vitet që pasuan pas kapërcimit të shekujve, më 1900-ën, Gjeçovi pati angazhim të plotë në shumë fusha të kulturës dhe të arsimit. U konsolidua si shkrimtar, duke shkruar në të tria gjinitë letrare. Detyra e françeskanit e çoi në shumë vende dhe kudo ku shkonte mblodhi shkrime të rralla, këngë, mite, legjenda, përralla, doke e zakone popullore, por një ndër kryeveprat e tij është “Kanuni i Lekë Dukagjinit”, i cilësuar pa rezerva monument i gjuhës dhe kulturës së Kombit Shqiptar. Vepra e Gjeçovit e formatuar në 1263 nene, nisi të botohej për herë të parë tek “Albania” e Konicës më 1897-1898, më mbrapa edhe në organin e shtypit të françeskanëve që nga dalja e “Hyllit të Dritës”, më 1913, deri më 1924. Botimi i plotë doli më 1933, pas vdekjes së autorit me parathënie të Gjergj Fishtës; ndërkohë që titulli u përzgjedh nga Fishta që ishte një fjalëformim Lekë (malësor, sipas kumtit parak, banorët e Malësisë së Madhe) dhe Dukagjin. Më vonë “Kanuni” u përkthye pjesë-pjesë, nga mikesha e shqiptarëve dhe e Eqerem Vlorës, baronesha Marie Amelie von Godin, edhe me ndihmën e etërve françeskan. Ky punim bëri të mundur që më

1936, Universiteti 600 vjeçar gjerman i Lajpcigut në Drezden t’i akordojë titullin “Doktor i shkencave in honoris causa”, postum Shtjefën Gjeçovit për vleftën e Kanunit. Në gjuhën italiane, Kanuni u përkthye nga Pal Dodaj në bashkëpunim me Giuseppe Schiro dhe u botua nga Akademia e Arteve dhe Shkencave në Romë, më 1941. Shtjefën Gjeçovi ka edhe një seri veprash të tjera si, “Dashnia e atdheut”, drama “Agimi i qytetnisë”, “Shqiptari ngadhënjyes”, “Përkrenarja e Skënderbeut”, “Kanuni i Lekë Dukagjinit”, vepra “Trashëgime trako-ilire”, “Jeta e Shën Luçisë, Shna Ndou i Padues, Atil Reguli” – përkthim i lirë i dramës me 3 akte të Pjetër Metasatasit, “Vazja e Orleanit” ose “Zhan D’Ark” mbas A.F. prej Bergamos, punimi teologjik “Shpërblesi i botës ase Jeta e Jezu Krishtit”, e shkruar në frymën e gjuhës shqipe dhe në frymën e dashurisë për Krishterimin. Por shumica e veprave të Shtjefën Gjeçovit mbetën në dorëshkrim, si “Princi i Dibrave”, “Mojsi Golemi” (dramë), “Mnera e Prezës” etj., shumica e këtyre dorëshkrimeve ruhen në Arkivin e Shtetit në Tiranë. Puna e Shtjefën Gjeçovit është në vazhden e veprimtarëve të Rilindjes për të mbledhur e për të dëshmuar traditat kombëtare dhe lashtësinë historike, kulturën e tyre materiale dhe shpirtërore të shqiptarëve, duke lëvruar fjalën shqipe dhe ngritur ndërgjegjen kombëtare. Edhe vepra “Kanuja” u botua pas vrasjes së tij. Gjeçovit i janë kushtuar shkrime të shumta, si françeskani Atë Pashkë Bardhi, historiani i fretërve që e njohu nga afër, por mbi të gjitha qëndron monografia “Shtjefën Gjeçovi, Jeta, vepra”, shkruar nga Ruzhdi Mata. Shtjefën Gjeçovi mbeti monument vlerash të pashterueshme, pishtar i ndriçimit të historisë, gjuhës dhe kulturës së kombit. Monumentale ka ngelur shprehja e tij: “Giuha e një komit s’kaa t’ndalun, as nuk mûnd t’ndâlet kurr”. “Sa mûnd t’mëndohet dielli pa dritë, aq mund t’mëndohet komi pa giuhë”. Vlerat e gjuhës dhe kulturës qëndrojnë në themel të kombit pasi “...giuha është një gjâa sënd qi nuk mûnd t’blehet, nuk shitet e nuk ndrrohet; një sënd është, qi do t’ruhet si një gur i çmue, do t’ruhet si një dhântii e posaçme e Perendisë e si një trashigim i t’parve tonë... do t’ruhet si drita e synit. Kjo dhântii... është giuha shqype”. Bashkëkohës dhe studiues të të gjitha kohërave përbashkohen në vlerësimin e figurës së Shtjefën Gjeçovit: Figurë poliedrike e historisë dhe kulturës shqiptare, që punoi fort në gjithë fushat e diturisë, që çuditi me kulturën e tij Faik Konicën, i cili e përshkruan me nderim e simpati të thellë; mrekulloi shkrimtarin e ri të shkollës letrare shkodrane, Dom

Lazër Shantojën, i cili i kushtoi një portretizim të veçantë, duke e radhitur përkrah Fishtës e Harapit. Gjeçovi është klasifikuar si historian, etnograf, arkeolog, mbrojtës i flaktë i sigurisë njerëzore gjatë Luftës Kombëtare të Vlorës.

Gjeçovi - dëshmor me dokumente juridike pothuaj një shekull pas vrasjes

Duke përkujtuar 150-vjetorin e lindjes së Shtjefën Gjeçovit, sjellim në vëmendje të lexuesit përpjekjet për shpalljen dëshmor i Atdheut të një figure që i ngriti vetvetes me vepra një monument të pavdekësie, pasi Shtjefën Gjeçovi ishte dhe mbeti pishtar i gjallë i ndriçimit të historisë dhe kulturës së kombit shqiptar. Ja vlen shumë të sjellim në vëmendje postulatit ndaj shqiptarizmsë: “Giuha e një komit s’kaa t’ndalun, as nuk mûnd t’ndâlet kurr”. “Sa mûnd t’mëndohet dielli pa dritë, aq mund t’mëndohet komi pa giuhë” . Ai i bën të ditur patriotëve të tij vlerat e gjuhës: “është një gjâa sënd qi nuk mûnd t’blehet, nuk shitet e nuk ndrrohet; një sënd është, qi do t’ruhet si një gur i çmue, do t’ruhet si një dhântii e posaçme e Perendisë e si një trashigim i t’parvet tonë... do t’ruhet si drita e synit. Kjo dhântii... është giuha shqype”. E mbyll paragrafin, duke vendosur në fund këtë aforizëm: “Sa mûnd t’mëndohet dielli pa dritë, aq mund t’mëndohet komi pa giuhë”. Shtjefën Kostandin Gjeçovi, veprimtar i lëvizjes kombëtare shqiptare, frat françeskan, etnolog, arkeolog, poet e shkrimtar i spikatur, filozof, përhapës i shkollave shqipe në Shqipërinë e këtej Drinit dhe matanë Drinit, “Mësues i popullit”, iniciator për unifikimin e gegërishtes me toskërishten, mbrojtës i paepur i sigurisë së qytetarëve të Vlorës përgjatë Luftës Kombëtare të Vlorës të 1920-ës dhe figurë me përmasa të madha kombëtare. Mëhill Gjeçi-Kryeziu është quajtur për 22 vjet, nga lindja e tij, më 12.7.1874 deri më 29.6.1896, kur e ka ndryshuar emrin në Shtjefën Kostandin Gjeçovi, pasi përfundoi studimet e larta teologjike në Kreshevë të Dalmacisë dhe në regjistrat françeskan zhduket emri Hilë Gjeçi dhe zëvendësohet me Shtjefën Konstantin Gjeçovi. Faik Konica e ka cilësuar Gjeçovin si, “njeri nga njerëzit më të lartë që ka pasur Shqipëria”, ndërsa albanologu austriak Norbert Jokli e ka quajtur, “punëtor i palodhur në fushën e letrave shqipe”. Gjeçovi bashkëpunoi me revistat e kohës: “Populli”, “Hylli i dritës”, “Albania”, “Brezi i ri”, ku ne e gjejmë me pseudonimet “Komnen Kanina”, “Lkeni i Hasit”, “Zana e Prezës”, “A.Sh.K.Gj”, “O.F.M”, dhe nga ana tjetër la rreth 10 000 faqe dorëshkrime. Ai ishte si një “makinë intelektuale” enciklopedike, i cili njihte tetë gjuhë të huaja dhe që konsiderohet “Instituti shkencor gjeçovian”. Gjeçovi ka ngelur përjetësisht në memorien e kombit edhe si rezultat i një nisme të djemve të fshtatit të tij të origjinës Kryeziut dhe kryesisht mikut tonë zoti Bilbil Dervishi (bashkëfshatar i dëshmorit) si dhe Shoqatës Kulturore Atdhetare “Labëria” Dega e Tiranës, Shoqatës së Historianëve Ushtarakë Shqiptarë e kryetarit Profesor Bernard Zotaj si dhe Sekretarit të Përgjithshëm që formatuan një dosje voluminoze për fratin françeskan që jetën e dha për shqiptarizmin, për gjuhën dhe shkollën shqipe. Këtu nuk mund të lëmë edhe falënderimin për profesore Pranvera Dibra, ish-Drejtoreshën e Arkivit të Ministrisë për Europën dhe Punët e Jashtme, që mundësoi dokumente sipas origjinalit për vrasjen e Shtjefën Gjeçovit, por dhe për dokumentet e diskutimet në parlamentin e Shqipërisë të vitit 1929, ku për herë të parë përmendet termi “dëshmor”, për një bir të madh të shqiptarizmsë. Shpallja ‘dëshmor’ është një ndërmarrje jo e vogël, megjithëse për këtë rast kemi pasur mbështetje nga Bashkia e Pukës, Këshilli Bashkiak si dhe Prefektura e Shkodrës. Fakt është se mësuesi i Kombit Shtjefën Gjeçovi është varrosur në Shëngjergj afër Zymit të Hasit. Në Zym të Hasit të Thatë gjendet edhe qendra memoriale e ndërtuar në nder të tij. Por pas daljes së Vendimit për shpallen e tij dëshmor i Atdheut, bazuar në ligjin e shtetit shqiptar Nr. 109/2018 “Për statusin e Dëshmorit të Atdheut”, Neni 13 i ligjit “Vendprehja e dëshmorëve të atdheut”, që thotë: “4. Varrimi i dëshmorit të atdheut apo rivarrimi i mbetjeve mortore të tij në varrezën e dëshmorëve të atdheut “Nëna Shqipëri”, në kryeqytet, bëhet me vendim të Komisionit Qendror të Statusit “Dëshmor i atdheut”, me kërkesë të këshillit bashkiak, këshillit të qarkut, prefektit ose ministrit. 5. Varrimi i dëshmorit të atdheut apo rivarrimi i mbetjeve mortore të tij në varrezat e dëshmorëve të atdheut në qarqet përkatëse bëhet me vendim të këshillit të qarkut, këshillit bashkiak ose të prefektit”. Në nenin 14 të ligjit shkruhet: “Ceremonia e varrimit të dëshmorit të atdheut. Varrimi i dëshmorit të atdheut apo rivarrimi i mbetjeve mortore të tij bëhet me ceremoni zyrtare, me arkivol të mbuluar me flamurin kombëtar”. Por për rastin e dëshmorit Shtjefën Gjeçovi i kapërcen përmasat lokale dhe është i pamjaftueshëm edhe përkujtimi që më 12 korrik 2024 i bëri Muzeu Historik Kombëtar At Shtjefën Gjeçovit për ditën e tij të lindjes. Gjykojmë se kërkohet një vendim i posaçëm dhe varrosja e eshtrave të tij gjykojmë se meriton të prehet në varrezat e dëshmorëve të kombit në Tiranë, ose në konsensus midis strukturave qeveritare të Prishtinës dhe të Tiranës. Në Tiranë dhe Prishtinë Shtjefën Gjeçovi meriton një nderim e vlerësim më dinjitoz për vlerat që përfaqëson sikurse meriton buste të tij në Janjevë të Kosovës si dhe një muze e monument në Kryezi të Pukës.

Burimet e studimit: AQSH, Fondi 58, Shtjefën Gjeçovi, Dosja 95/14 dhe 95/15, si dhe të dhëna të marra nga Arkivi i Ministrisë së Jashtme dhe Çështjeve Europiane.



KALENDARI 2024

I APLIKIMIT NË UNIVERSITETE

• RAUNDI I •

KOHËZGJATJA

